



**AUTORITETI I
KONKURRENCËS**

RAPORTI VJETOR **2011**

DHE

SYNIMET KRYESORE TË PUNËS PËR
VITIN **2012**

Autoriteti i Konkurrencës

Adresa: Rr. Sami Frashëri, nr. 4,
Kati IV, Tiranë

Tel: +355 4 2 234 504

Fax: +355 4 2 234 497

Faqe e internetit: www.caa.gov.al

Email: competition@caa.gov.al

Tabela e Përmbajtjes

Fjalim përshendetës i Kryetarit të Komisionit	4
I. Përmbledhja e zhvillimeve kryesore.....	6
I.1. Karakteristikat e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës.....	6
I.2. Rreth Autoritetit të Konkurrencës	8
I.2.1 Përfitimet nga konkurrenca	9
I.2.2 Struktura organizative dhe funksionet e Autoritetit të Konkurrencës	10
II. Zbatimi i ligjit të konkurrencës	14
II.1. Ankesat e biznesit.....	14
II.1.1 Ankesat për kufizime të konkurrencës	15
II.1.2 Ankesat jashtë objektit të ligjit	16
II.2. Marrëveshjet e ndaluara (kartelet).....	18
II.2.1 Hetimi në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në Qytetin e Vlorës.....	18
II.2.2 Hetimi paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike.....	19
II.3. Abuzimi me pozitën dominuese.....	19
II.3.1 Hetimi i thelluar në tregun e shërbimit, ngarkim- shkarkimit të GLN në Porto Romano	19
II.3.2 Hetimit paraprak në tregun e ofrimit të kartave me parapagesë.....	20
II.3.3 Hetimi paraprak në tregun e linjave, të shitjes me shumicë dhe pakicë, të aksesit për operatorët e telekomunikacioneve dhe përdoruesve fundorë	21
II.3.4 Hetimi në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të produktit oriz, sheqer dhe në tregun e importit dhe të prodhimit të vajit vegjetal.....	22
II.4. Monitorimet e tregut.....	22
II.4.1 Monitorimi i tregut të importit dhe prodhimit të grurit dhe miellit	22
II.4.2 Monitorimi i tregut të shërbimit të transportit detar për pasagjerët.....	22
II.4.3 Monitorimi i tregut farmaceutik	23
II.5. Përqëndrimet	23
II.6 Rishikimi gjyqësor dhe ekzekutimi i vendimeve të Komisionit të Konkurrencës.	28
III. Advokatia dhe kultura e konkurrencës	30
III.1. Advokatia e konkurrencës	30
III.1.1. 1. Vlerësimi i akteve dhe draft-akte normative	30
III.1.2. Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe udhëzues mbi zbatimin e ligjit të konkurrencës	33
III.1.3. Aktet nënligjore.....	35
III.2. Kultura e konkurrencës – marrëdhëniet me publikun dhe mediat.....	36
III.2.1. Marrëdhënia me publikun	37
III.2.2. Marrëdhënia me median	37
IV. Bashkëpunimi ndërkombëtar	38
IV.1 Bashkëpunimi me Komisionin Europian.....	38
IV.1.1 Detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizimi-Asociimit për Autoritetin e Konkurrencës	39
IV.1.2 Raportimi periodik	39
IV.1.3 Projektet e mbështetjes IPA 2008	40

IV.2. Bashkëpunimi me OECD (RCC Budapest).....	41
IV.3. Bashkëpunimi me Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës (ICN) dhe Autoritet e Rajonit. ...	41
V. Prioritetet e punës për vitin 2012	43
V.1. Zbatimi i ligjit të konkurrencës	43
V.2. Advokacia dhe kultura e konkurrencës	44
V.3. Hartimi i dokumentit të ri të Politikës së Konkurrencës	44
V.4. Rritja e kapaciteteve administrative	45
Shtojcë 1: Të dhëna statistikore mbi vendimet e Komisionit të Konkurrencës sipas viteve	46
Shtojcë 2: Ekzekutimi i gjobave të vendosura nga Komisioni deri më 31 Dhjetor 2011	47
Shtojcë 3: Struktura e Autoritetit të Konkurrencës	48
Shtojcë 4: Përqëndrimet e njoftuara dhe të autorizuara	49
Shtojcë 5. Lista e Vendimeve të Komisionit për ekzekutimin e gjobave	50
Shtojcë 6. Pasqyra e rishikimit gjyqësor të vendimeve të Komisionit të Konkurrencës	51
Shtojcë 7: Matrica e vlerësimeve të dhëna nga Autoriteti i Konkurrencës për vitin 2011	52
Shtojcë 8. Buxheti faktik i Autoritetit të Konkurrencës	59

Fjalim përshendetës i Kryetarit të Komisionit

Shpesh kohët e fundit është artikuluar domosdoshmëria e krijimit të një klime për biznesin e tillë që të mundësojë "rritjen e biznesit dhe lulëzimin e inovacionit"¹. Politikat e konkurrencës duhet të përbëjnë thelbin e politikave të zhvillimit ekonomik, duke krijuar mundësinë e hyrjeve në treg të bizneseve të reja dhe realizimin e një konkurrence efektive midis lojtarëve.

Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës ka misionin e mbrojtjes dhe të nxitjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, për realizimin e të cilit janë përcaktuar vizioni i Komisionit të Konkurrencës dhe objektivat e veprimtarisë së institucionit të konkurrencës. Masa e plotësimit të këtij objektivi qëndror është konsideruar edhe si treguesi i përformacës së këtij institucioni.

Por jo vetëm, pasi mirëfunksionimi i tregut kërkon bashkëveprim ndërinstitucional me të gjitha entet rregullatore dhe institucionet e tjera publike. Përmirësimi i instrumentave për rritjen e advokacisë dhe kulturës së konkurrencës është konsideruar si një kusht jetik për një efekt real në treg të Autoritetit të Konkurrencës, për të cilën është investuar dhe do të vazhdojë të investohet jo vetëm nga qeveria, por edhe nga projektet e financuara nga Bashkimit European. Për më tepër, proceset integruese kanë jetikë ndërveprimin me të gjithë palët e interesit, komunitetin e biznesit dhe konsumatorit, median dhe shoqërinë civile, pra me gjithë publikun e gjërë.

Autoriteti i Konkurrencës, si një e mirë publike, në vijimësi ka qënë aktiv duke përdorur të gjithë fuqinë që i ka dhënë Ligji dhe Politika e Konkurrencës, për të mbrojtur tregjet nga veprimet antikonkurrese të disa lojtarëve, të cilët sjellin dëm jo vetëm konkurrentëve të tyre por, në thelb, mirëqënies së konsumatorëve.

Ndërhyrjet e menjëhershme në rastet e identifikuar, penalizimi i marrëveshjeve të ndaluara, mbikëqyrja e sjelljes së ndërmarrjeve me fuqi tregu dhe penalizimi , si dhe ushtrimi i kontrollit ndaj transaksioneve që sjellin përqëndrimin e strukturave të tregut, janë instrumentat ligjorë që ka përdorur institucioni i konkurrencës. Në bazë të këtyre instrumentave qëndron drejtësia, barazia, paanësia, transparenca, objektiviteti dhe profesionalizimi, parime të cila kanë sjellë rritjen e profilit publik të Komisionit të Konkurrencës dhe të institucionit në përgjithësi.

Sa më tepër ndërhyjnë në treg institucioni i konkurrencës, aq më të sofistikuar bëhen mënyrat e shfaqjes së praktikave antikonkurrese nga lojtarët e fuqishëm të tregut, prandaj rritja e profesionalizimit dhe sofistikimi i instrumentave investiguese, përbën një sfidë të vazhdueshme për institucionin e konkurrencës, sfidë e cila bëhet akoma dhe më e evidente me rritjen e ankesave të biznesit për sjelljet antikonkurrese.

Rritja e shpejtësisë së trajtimit të ankesave dhe ndërtimi i taktikave në mënyrën e duhur për të përmirësuar instrumentin e downraids (inspektimit të rrufeshëm), përbëjnë sfidat e së ardhmes për të cilat Autoriteti i Konkurrencës ka patur dhe ka parasysh, për të qënë një institucion që plotëson në mënyrë progresive standardet dhe kërkesat e rritjes së ekonomisë shqiptare.

¹ "New Frontiers of Antitrust 2012", shkurt 2012, fjalimi i Z. Joaquin ALMUNIA, Zv Presidenti i Komisionit European

Rritja e kapaciteteve të Autoritetit të Konkurrencës gjithnjë e më shumë konsiderohet e lidhur ngushtë me zgjerimin e njohurive mbi specifikat e ligjit dhe të plotikës së konkurrencës me të gjithë palët e interesit, si entet rregullatore, institucionet qendrore dhe lokale, gjyqësorin dhe studiot ligjore, mediat dhe komunitetin e biznesit dhe atë të konsumatorit. Pasi, një praktikë antikonkurruese nuk është thjesht një shkelje administrative, por një mundësi e hequr konsumatorit për të përfituar produkte me çmime më të lira, me cilësi më të mirë, më shumë zgjedhje, pra një mirëqenie më e mirë.

Prandaj është detyrim moral dhe ligjor i të gjithë palëve të interesit që të bashkëpunojnë për të mbrojtur dhe nxitur konkurrencën e lirë në treg si domosdoshmëri për rritjen ekonomike të vendit dhe të mirëqënies së popullit.

I. Përmbledhja e zhvillimeve kryesore

Autoriteti i Konkurrencës funksionon në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Politikës Kombëtare të Konkurrencës, si dhe të normave dhe praktikave më të mira të administratës publike dhe të së drejtës europiane të konkurrencës.

Gjatë vitit 2011, institucioni i konkurrencës ka realizuar objektivat e përcaktuara nga rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2010, synimet e prezantuara në “Raportin vjetor 2010 dhe synimet kryesore për 2011”, si dhe në Raportin e Progresit të Bashkimit European për vitin 2010- 2011.

I.1. Karakteristikat e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës

Puna e Autoritetit është fokusuar kryesisht në rritjen e shpejtësisë së veprimit në përgjigje të ankesave; në rritjen e llojeve të tregjeve që kanë qënë objekt i monitorimit dhe i hetimeve, apo i kontrollit dhe vlerësimit të përqëndrimit nga institucioni i konkurrencës; plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor sekondar duke reflektuar zhvillimet më të fundit të rregulloreve e praktikave më të mira të Bashkimit European, si dhe në eksperiencat tona; përmirësimin e instrumentave për forcimin e advokacisë së konkurrencës dhe liberalizimin e mëtejshëm të tregjeve; konsolidimin e shkallës së ekspertizës dhe rritjen e kapaciteteve administrative; si dhe rritjen e kulturës së konkurrencës nëpërmjet bashkëpunimit jo vetëm me shoqatat e biznesit dhe ato të mbrojtjes së konsumatorit, por edhe me publikun e gjërë.

Sikurse është prezantuar edhe në raportin e vitit 2010, një nga objektivat e institucionit të konkurrencës ka qënë përmirësimi i të gjithë instrumentave për nxitjen e komunitetit të biznesit për t'ju drejtuar Autoritetit të Konkurrencës për të gjitha shqetësimet që lidhen me konkurrencën në përgjithësi. Viti 2011 filloi me një numër të konsiderueshme të **ankesave** nga ana e ndërmarrjeve lidhur me praktika të mundshme të abuzimit me pozitën dominuese, një tregues i qartë ky i rritjes së rolit të Autoritetit të Konkurrencës në ndërhyrjet për rivendosjen e konkurrencës në treg. Gjatë këtij janë depozituar 13 ankesa pranë institucionit tonë, nga të cilat 5 prej tyre kanë prezantuar shkelje potenciale të konkurrencës në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Sekretariati i Konkurrencës, pasi ka realizuar monitorimet bazuar në këto ankesa, i ka kërkuar Komisionit të Konkurrencës hapjen e procedurave përkatëse hetimore. Këto ankesa kanë qënë kryesisht për abuzimin potencial me pozitën dominuese në tregun e ngarkim-shkarkimit të Gazit të Lengshëm të Naftës (GLN) në rrugë detare; tregun e kartave me parapagesë në telefoninë fikse, tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, etj.

Risia e inspektimeve të vitit të kaluar ishte fillimi i procedurave në mënyrë të menjëhershme me marrjen e sinjaleve nga ankesat apo nga mediat dhe realizimi i inspektimeve (në formën e down raids) në të njëjtën kohë në shumicën e ndërmarrjeve nën hetim me qëllim **rritjen e efikasitetit të investigimit**, që ishte shpallur edhe një nga objektivat e paraqitura në raportimin vjetor të vitit të kaluar. Për rritjen e efciences së inspektimeve, kanë ndikuar mësimet nga eksperiencat e mëparshme, investimet në trajnimet e realizuara nga projekti i binjakëzimit të

financuar nga IPA-2008, si dhe mbështetja proaktive nga Komisioni i Konkurrencës në zbatim të procedurave të përcaktuara nga Ligji.

Gjatë vitit 2011, Autoriteti i Konkurrencës ka përfunduar monitorimet dhe hetimet e filluara në vitin 2010 në tregje të tilla si: tregu i importit të sheqerit, të orizit dhe në tregun e importit dhe të prodhimit të vajit vegjetal; apo, tregu i telekomunikacioneve, i cili ka qënë objekt i një numri të madh të ankesave të operatorëve ndaj njëri tjetrit.

Gjatë vitit 2011, tregu i telekomunikacioneve ka qënë objekt hetimi edhe në aspekte të tjera të shkeljeve të mundshme të konkurrencës, si në atë të kartave me parapagesë për abuzimin e mundshëm me pozitë dominuese të ndermarrjes që operon në tregun e telefonisë fikse. Një treg tjetër që është aktualisht në fazën e vendimmarrjes, për abuzimin e mundshëm me pozitë dominuese, është tregu i ngarkim-shkarkimit të GLN-së në rrugë detare.

Gjatë vitit 2011, kanë filluar dhe përfunduar procedurat hetimore në tregun e prodhimit të bukës masive në qytetin e Vlorës, në të cilin 20 operatorë lokalë janë penalizuar për pjesëmarrjen në marrëveshje për fiksime të çmimit dhe katër prej tyre për moszbatimin e vendimit të Komisionit të Konkurrencës për masat e përkohëshme për ndalimin e kësaj marrëveshje, si marrëveshje të ndaluar që sjell kufizimin e konkurrencës në treg. Gjithashtu, gjatë vitit të kaluar ka filluar procedurën e hetimit për marrëveshje të ndaluar në tregun e prokurimeve të shërbimit të rojeve dhe sigurisë fizike.

Sinjalet për kufizime apo shtrembërime të mundshme të konkurrencës në tregje merren edhe përmes monitorimeve që janë puna jone e vazhdueshme. Prandaj gjatë vitit të kaluar janë kryer monitorime jo vetëm për tregjet që më parë kanë qënë objekt hetimi, si tregu ushqimor, tregu i hidrokarbureve, por edhe për tregje të tjera si psh. tregu i shërbimeve (transporti detar dhe tregu farmaceutik), etj.

Viti 2011 shënoi një **ritje të numrit të përqëndrimeve** të njoftuara pranë Autoritetit të Konkurrencës si pasojë e ndërgjegjësimit të palëve pjesëmarrëse në transaksione, por dhe uljes së ndjeshme të kufijve të xhiros për autorizimin e përqëndrimeve nga ana e Komisionit të Konkurrencës. Komisioni i Konkurrencës ka autorizuar 10 raste të ndryshimit të kontrollit ndaj ndërmarrjeve kryesisht në tregjet e sigurimeve, shërbimet bankare dhe tregun e automjeteve, ku kanë ndodhur dhe përqëndrimet kryesore gjatë vitit 2011. Për ushtrimin e kontrollit ex-post, Autoriteti i Konkurrencës nuk ka qënë thjesht pasiv, duke pritur njoftimet e ndërmarrjeve për transaksionet potenciale në të cilat ato ishin përfshirë, por ka mbajtur një qëndrim proaktiv duke ndërmarrë veprime për identifikimin e të gjitha transaksioneve të ndodhura dhe të evidentuara në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit (QKR). Pra, në bashkëpunim shumë të ngushtë me QKR-në u mundësua kontrolli i të gjitha transaksioneve të ndodhura që përmbushnin kushtin ligjor për të qënë objekt kontrolli dhe autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Lidhur me analizën në fushën e **advokacisë së konkurrencës** gjatë vitit 2011 Autoriteti i Konkurrencës në kuptim të neneve 69 dhe 70 të Ligjit, është shprehur rast pas rasti për aktet që mund të kufizonin konkurrencën në tregun përkatës. Rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës janë dhënë kryesisht për tregje ku për shkak të natyrës (kufizimi i lejeve/licensave) të tregut dhe/ose veprimit të autoriteteve rregullatore janë vënë re kufizime potenciale të konkurrencës. Tregu i energjisë elektrike, komunikimeve elektronike, shërbimi postar etj., janë disa nga tregjet kryesore për të cilat janë adresuar rekomandimet.

Përmirësimi i instrumentave për rritjen e forcimit të advokacisë dhe të kulturës së konkurrencës është mundësuar edhe nga përdorimi me efikasitet dhe eksperiencës së marrë nëpërmjet projekteve të binjakëzimit dhe të asistencës teknike të financuar nga IPA-2008. Kështu janë ndërmarrë aktivitete trajnime të bashku me rregullatorët e sektorëve financiarë, energjisë, telekomunikacionit, apo seminare rajonale me komunitetin e biznesit dhe atë universitarë në qytetet Durrës dhe Vlorë, praktika të cilat do të vazhdojnë edhe në vitin 2012.

Gjithashtu, draftimi i një sërë aktesh nënligjore në kuadër të ndryshimit të Ligjit të Konkurrencës dhe përafrimit të mëtejshëm të legjislacionit me acq-communitaire përbën një objektivi tjetër të realizuar si dhe një fushë të ndërhyrjes së AK-së. Qëndrimi proaktiv i institucionit të konkurrencës për respektimin e lirisë ekonomike konsiston edhe në hartimin, miratimin dhe publikimin e udhëzuesve shumë të rëndësishëm për të zbuluar marrëveshjet midis firmave në prokurimet publike, apo për vlerësimin e koncesioneve, procese të asistuar edhe nga ekspertët e projekteve të financuara nga Bashkimi Europian.

Gjatë vitit të kaluar Komisioni i Konkurrencës ka marrë 43 vendime, pa përfshirë opinionin për një sërë vlerësimesh ligjore të adresuara për draft-aktet e hartuara nga entet rregullatore dhe institucione të tjera qëndrore. Këto vendime konsistojnë në zbatim të Ligjit ‘Për mbrojtjen e konkurrencës’ dhe konkretisht janë dhënë: 3 vendime për masa të përkohëshme për ndalimin e praktikave anti konkurrese; 1 vendim për vendosje gjobe ndaj 20 ndërmarrjeve; 6 vendime për miratimin e rregulloreve apo udhëzuesve; 5 vendime me rekomandime të adresuara enteve rregullatore dhe institucioneve të tjera qëndrore; 10 vendime për autorizimin e transaksioneve të përqendrimeve; si dhe 19 vendime për zbatimin e procedurave të brendshme të Autoritetit të Konkurrencës. Numri në rritje të dukshme i vendimeve të Komisionit të Konkurrencës dhe me tiparin shumëdimensional të tyre, reflekton volumet e punës së realizuara nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës (shih Shtojcën 1).

Rishikimi gjyqësor i vendimeve të Komisionit të Konkurrencës ka konfirmuar 7 nga 12 vendime të ankimuara. Gjithashtu, ato kanë vërtetuar se procedurat e ndjekura nga Autoriteti janë të konsoliduara dhe nuk janë kundërshtuar apo ankimuar. Gjithashtu, **ekzekutimit të gjobave** të vendimeve të Komisionit të Konkurrencës ka kaluar në një fazë të re gjatë vitit 2011 pasi tashmë pjesa më e madhe e vendimeve që kanë marrë formë të prerë janë arkëtuar apo janë në proces ekzekutimi dhe pritet të përfundojnë arkëtimet në llogarinë e buxhetit të shtetit. Sikurse paraqitet edhe në Shojcën 2, janë arkëtuar rreth 24 % e shumës së gjobave të vendosura gjithsej nga Komisioni i Konkurrencës dhe janë në proces 20 % të tjera (shuma totale e gjobave 1,093,503,130 lekë).

Një objektivi tjetër për vitin e kaluar ka qënë **forcimi i kapaciteteve administrative** nga pikëpamja cilësore. Viti 2011 ka qënë një vit i ngjeshur me trajnime në sajë të dy projekteve të financuara nga BE-ja, ai i binjakëzimit me autoritet homologe italiane dhe hungareze (rreth 150 ditë trajnime) dhe i asistencës teknike. Gjithashtu, pjesëmarrje aktive me prezantime rastesh ka patur edhe në seminarët e organizuara nga OECD-ja në Qendrën Rajonale në Budapest.

I.2. Rreth Autoritetit të Konkurrencës

Ligji dhe Politika Kombëtare e Konkurrencës janë hartuar me objektivi kryesor konkurrencën e lirë dhe efektive në treg dhe me qëllimin

përfundimtar mbrojtjen dhe përfitimet për konsumatorët. Misioni i Autoritetit të Konkurrencës është t'i bëjë tregjet konkurruese dhe ekonominë e tregut funksionale, pikërisht në funksion të mirëqënies konsumatore dhe prosperitetit ekonomik të vendit në tërësi.

Praktika ka treguar se atje ku ka mungesë të konkurrencës, si për shembull në rastet e karteleve apo abuzimit me pozitën dominuese (rasti ekstrem i monopoleve), bizneset nuk konkurrojnë dhe si rezultat konsumatori paguan çmime të larta, ka pak mundësi zgjedhjeje dhe cilësi më të dobët të produkteve dhe shërbimeve. Është e provuar që në kushtet kur në treg ka konkurrencë, çmimet janë më të ulta, zgjedhjet konsumatore më të mëdha dhe cilësia e shërbimit më e mirë.

1.2.1 Përfitimet nga konkurrenca

Për një perceptim sa më të drejtëpërdrejtë mbi mënyrën se si veprimtaria e institucionit të konkurrencës ndikon në treg, në vijim do të paraqitet një shembull se si Autoriteti i Konkurrencës ndërhyr në treg për të ndaluar praktikant antikurruese dhe promovon konkurrencën në treg nëpërmjet rekomandimeve. Pjesa e dytë e këtij seksioni do të pasqyrojë strukturën organizative të Autoritetit të Konkurrencës.

Shembulli më domethënës për Shqipërinë është tregu i telefonisë së lëvizshme. Në maj 1998 filloi operimin kompania e parë AMC në një treg monopolistik me çmime stratosferike të aksesit (rreth 100 mijë lekë kushtonte posedimi i një numri). Në 25.07. 2000, Telenor - Cosmote bleu 85 % të aksioneve të AMC-së, pjesa tjetër prej 12.6% të aksioneve zotërohen nga Shteti Shqiptar të administruara nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes së Shqipërisë dhe 2.4% zotërohen nga aksionerët e vegjël, punonjës të AMC-s në kohën e privatizimit. Për rreth 5 vjet tregu ishte monopol (i transferuar nga monopol shtetëror në një monopol privat) ku dukshëm hyrja e kapitalit të huaj në një treg të pazhvilluar dhe me uri për shërbimin e telefonisë solli ndryshime rrënjësore në treg, rritje e fortë e abonentëve, zonës së mbulimit, shërbimeve etj., kundrejt tarifave të shtrenjta krahasuar me kostot dhe tarifën në rajon dhe duke shfrytëzuar shkallën e ulët të penetrimit të telefonisë fikse.

Më 9 qershor 2001, Vodafone, licencohet si operator i dytë i shërbimit celular në Shqipëri (licensa nr.2), me kapital të përbashkët të Vodafone International Holding (51% të aksioneve) dhe Panafone International Holding (49 % të aksioneve).

Gjithë faktorët dhe aktorët e tregut prisnin ndryshime të forta, sidomos me uljen e tarifave, pas hyrjes së operatorit të dytë në një treg me strukturë duopolistike. Por në mungesë të një metodologjie që do ankoronte tarifën drejt kostos sipas ligjit (tarifa jo më shumë se 130 % e kostos), dy kompanitë thuajse nuk konkuruan me tarifën, por vetëm me elemente të marketingut.

Nga analiza e tregut rezultoi se në mungesë të një metodologjie të tarifave që nuk do lejonte çmime më të larta se 130 % e kostos (Miratimi i metodologjisë është detyrë ligjore e Entit Rregullator) , mund të përdoret alternativa krahasuese (benchmark -u) të tarifës së shërbimit me ato të shërbimeve respektive, ose të ngjashme në rajon. Sipas "Cullen Report 2 – Country Comparative Report (2006) "Shqipëria përfaqëson një përjashtim në lidhje me çmimet, që e vendos atë midis vendeve me çmime më të larta të EU-së". Sipas hetimit, të dyja shoqëritë kishin aplikuar tarifa për shërbimin me kartë për thirrjet brenda rrjetit dhe jashtë rrjetit, më

të larta se sa mesatarja e rajonit; tarifë terminimi kombëtar mbi dy herë më të lartë, krahasimisht me tarifën mesatare të terminimit të vendeve të rajonit; tarifa për shërbimin me parapagim mesatarisht mbi dy herë më të larta se mesatarja respektive e vendeve të rajonit etj..

Në fund të një procesi hetimor, Komisioni i Konkurrencës konstatoi se shoqëritë AMC dhe Vodafone kishin abuzuar me pozitën dominuese duke vendosur çmime të padrejta në tregun e telefonisë së lëvizshme dhe shkelur në këtë mënyrë nenin 9 të ligjit "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe vendos t'i gjobisë respektivisht AMC sha me 211 552 000 lekë dhe Vodafone Albania sha me 242 633 000 lekë.

Në të njëjtën kohë, Komisioni i Konkurrencës rekomandoi një sërë masash për Entin Rregullator (sot AKEP), të cilat do të mundesonin konkurrencën në tregun e telefonisë së lëvizshme. Miratimi i metodologjisë së tarifave, licensimi i operatorit të tretë dhe më pas hyrja e një operatori të katërt si dhe mundësimi i portabilitetit të numrave ishin rekomandimet kryesore të Autoriteti i Konkurrencës të cilat u zbatuan gradualisht nga Rregullatori.

Kështu hyrja e dy operatorëve të tjerë, "Eagle Mobile" dhe "Plus", miratimi i metodologjisë së tarifave (që nga shtatori 2008) dhe mundësimi i ndryshimit të operatorit duke mbajtur të njëjtin numër (portabiliteti) kanë mundësuar një konkurrencë efektive në tregun e telefonisë së lëvizshme. Sot tregu shfaqet dinamik dhe konkurrenca ndjehet në çdo segment të tij (telefonata me zë, sms, thirrje brenda grupi, ndërkombëtare, internet) etj.., aq sa kompanitë po garojnë kush e ka më të lartë shpejtësinë e internetit. Mjafton një ilustrim me shifra për të kuptuar ç'efekte positive për konsumatorët ka konkurrenca në treg: Me 500 lekë sot mund të flasësh 1000 minuta, të dërgosh 500 sms dhe disa megabite internet ndërkohë që para 6 vitesh me kaq lekë flisje vetëm 7-8 minuta, brenda ose jashtë rrejtis, pra rreth 125 herë më pak pa përfshirë koston e 500 sms (rreth 12 000 lekë) dhe shërbimin e internetit, një shërbim që as nuk ofrohej.

Sikurse paraqitet nëpërmjet shembullit, konkurrenca ka një impakt të konsiderueshëm edhe në konkurrueshmëri (pasi ka dhe faktorë të tjerë që ndikojnë). Për shembull rënia e kostos së shërbimit të telefonisë sjell uljen e kostos totale në aktivitetin e sektorit privat dhe publik në proceset e prodhimit apo shërbimit duke i bërë ndërmarrjet më konkurruese në një treg gjithmonë e më të hapur me vendet e rajonit dhe tregun e përbashkët europian.

Pra, nga konkurrenca përfitojnë konsumatorët, biznesi dhe ekonomia në tërësi. Konkurrenca i mban çmimet dhe kostot për biznesit në nivele të ulta. Ajo zgjeron zgjedhjet konsumatore dhe cilësinë për të gjithë aktorët e tregut, nxit inovacionin në formën e produkteve dhe shërbimeve të reja dhe është një mbështetje e mirë për rritjen ekonomike.

1.2.2 Struktura organizative dhe funksionet e Autoritetit të Konkurrencës

Struktura organizative e Autoritetit të Konkurrencës nuk ka patur ndryshime thelbësore gjatë vitit 2011 dhe paraqitet sipas Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë Nr. 182 datë 12.05.2008, ndërsa numëri i punonjësve është 32 punonjës, nga të cilët 20 persona janë staf teknik i përbërë nga ekonomistë dhe juristë (11 ekonomistë dhe 9 juristë).

I.2.2.1 Struktura organizative

Autoriteti i Konkurrencës përbëhet nga Komisioni i Konkurrencës, si organ vendimmarrës dhe Sekretariati si organ administrativ dhe hetimor. Në shtojcën Nr.3 është vendosur organigrama e Autoritetit të Konkurrencës.

- **Komisioni i Konkurrencës**

Komisioni i Konkurrencës si organ kolegjal ka ushtruar funksionin e tij vendimmarrës në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Gjatë vitit 2011 Komisioni i Konkurrencës ka shënuar progres të dukshëm si në drejtim të performancës së vendimmarrjes për zbatimin e ligjit në rastet antitrust duke nxitur diskutimet brenda Komisionit dhe mendimin alternativ, ashtu dhe në rritjen e transparencës nëpërmjet organizimit të seancave dëgjimore me palët dhe seancat konsultative me institucionet qendrore dhe entet rregullatorë. Komisioni i Konkurrencës vazhdon t’i ushtrojë funksionet e tij ligjore me pjesëmarrjen e katër komisionerëve (një nga të cilët kryetari).

Kabineti është një strukturë e rëndësishme mbështetëse që funksionon pranë Komisionit të Konkurrencës në mbështetje të Ligjit si dhe të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”. Qëllimi i punës së Kabinetit është ndjekja dhe mbështetja e punës së Kryetarit dhe Komisionit duke bashkëpunuar ngushtësisht me Sekretariatit për të siguruar një funksionim të harmonizuar të brendshëm të institucionit si një të tërë. Kabineti është përgjegjës për organizimin e mbledhjeve të Komisionit, zbardhjen e formulimit të vendimeve, dhënien e vlerësimeve ligjore, etj. Gjithashtu Kabineti asiston Kryetarin në marrëdhëniet me të tretët e me mediat.

- **Sekretariati**

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, është organi administrativ i ngarkuar me ligj për të kryer monitorimin dhe hetimin, për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në treg. Sekretariati përbëhet nga tre drejtori dhe sektori i analizës.

Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut realizon procesin e mbikëqyrjes së sjelljes së ndërmarrjeve në treg në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Politikës Kombëtare të Konkurrencës. Kjo drejtori përbëhet nga tre sektorë të emërtuar sipas tre shtyllave kryesore që prezantohen në ligj, pra sektori i abuzimit me pozitën dominuese, sektori anti-kartel dhe sektori i përqëndrimeve.

Drejtoria Juridike dhe Procedurave realizon argumentimin juridik të produkteve të veprimtarisë së Sekretariatit, drafton aktet rregullatore në zbatim të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe përfaqëson Autoritetin në proceset gjyqësore në mbrojtje të vendimeve të Komisionit ndaj akt-pasive nga palët e prekura. Kjo drejtori është e organizuar në dy sektorë: Sektori i Përafrimit të Legjislacionit dhe Procedurave dhe Sektori i Çështjeve Juridike dhe Hetimit.

Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme është struktura mbështetëse e funksionimit të Autoritetit të Konkurrencës në realizimin e misionit të tij për ruajtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Kjo drejtori realizon menaxhimin e burimeve njerëzore në përputhje me kërkesat dhe procedurat e ligjit nr 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”, programon zhvillimin e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve duke shfrytëzuar të gjitha burimet e mundshme si OECD, ICN, RCC, ITAP, Universiteti i Tiranës etj. Një drejtim tjetër i punës së kësaj drejtorie është mbulimi i veprimtarisë financiare të Autoritetit dhe mbajtja e përgjegjësisë së plotë për të gjitha procedurat e hartimit dhe të administrimit të fondeve të buxhetit, në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e buxhetit të Shtetit Shqiptar.

Spektori i studimit dhe analizës ka si mision realizimin e monitorimeve sistematike të tregjeve sipas detyrave të përcaktuara nga vendimet e Komisionit të Konkurrencës, si dhe vëzhgimin e kushteve dhe kryerjen e analizave ekonomike të strukturave të ndryshme të tregjeve.


I.2.2.2 Rritja e kapaciteteve administrative

Forcimi i kapaciteteve administrative përbën një nga sfidat e vazhdueshme të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2011, që shënon dhe vitin me numrin më të madh të trajnimeve për stafin e Autoritetit të Konkurrencës. Më shumë se 150 ditë trajnimi për inspektorët dhe stafin menaxherial të Autoritetit të Konkurrencës janë zhvilluar nga ekspertët e vendeve të Bashkimit Europian, Italia dhe Hungaria. Tematikat e trajnimit fokusoheshin si në aspektin e tregjeve më të rëndësishëm ku ndërhyjnë Autoriteti i Konkurrencës, ashtu dhe sipas ndarjes horizontale, abuzimi me pozitën dominuese, marrëveshjet e ndaluara, kontrolli i përqëndrimeve.

Në kuadër të Programit të Bashkimit Europian, IPA 2008, Autoriteti po përfiton nga zbatimi i dy projekteve: (i) programi i binjakëzimit dhe (ii) projekti i asistencës teknike. Objekti i programit të Binjakëzimit është sigurimi i një mjedisi konkurrues në Shqipëri, duke zbatuar ligjin në fushën e konkurrencës dhe në përputhje me Acquis Comunitaire, si dhe rritja dhe forcimi i efikasitetit dhe efektivitetit të kapaciteteve administrative në fushën e konkurrencës. Ndërsa, projekti i asistencës teknike synonte në përafrimin e legjislacionit shqiptar në fushën e Konkurrencës me atë të BE-së, rritja e kultures dhe advokacisë së konkurrencës si dhe financimi i disa publikimeve në këtë fushë.

Në kuadër të bashkëpunimit me qendren rajonale të OECD-së në Hungari janë zhvilluar 28 ditë kalendrike trajnime ku janë përfshirë të gjitha stafet teknike dhe janë trajnuar për çështje të ndryshme të konkurrencës. Gjithashtu, stafet teknike kanë marrë pjesë në të gjitha seminarët apo tryezat e rrumbullakta të realizuara nga entet rregullatore, apo dhe institucionet e tjera.

Proçesi i forcimit të kapaciteteve paraqitet sipas skemës së mëposhtme:



I.2.2.3 Manaxhimi financiar

Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2011 ka zbatuar me korrektësi kërkesat e Ligjit Nr.10355, datë 02.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011". Administrimi i vlerave materiale dhe monetare është konsideruar një fushë e rëndësishme e punës tonë duke zbatuar me korrektësi të gjitha aktet ligjore e nënligjore dhe normativat në përdorimin e fondeve buxhetore.

Sektori i financës në këtë institucion ndjek miradministrimin e shpenzimeve buxhetore të miratuara, të cilat janë të lidhura me aktivitetin e institucionit, si dhe ka nxjerrë dhe përpunuar të dhëna mbi realizimin e treguesve financiarë. Në tërësinë e vet ky sektor ka ndikuar në realizimin e objektivave që ka institucioni.

Buxheti i miratuar për vitin 2011 është realizuar në masën 90%. Informacioni i detajuar jepet në pasqyrën e paraqitur në Shtojcën nr 8, në të cilën pasqyrohet se mosrealizimi në masën 10 % ka ardhur kryesisht nga vendet vakante si dhe mbetje nga procedurat e prokurimeve të realizuar gjatë këtij viti.


II. Zbatimi i ligjit të konkurrencës

Ligji shqiptar i konkurrencës është ligji antitrust me një shkallë të lartë përputhshmërie me legjislacionin e Bashkimit European, i cili ka si qëllim kryesor mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Shtyllat kryesore të ligjit janë: marrëveshjet e ndaluara dhe abuzimi me pozitën dominuese, kontrolli i përqendrimeve, advokacia dhe kultura e konkurrencës.


Kjo pjesë do të paraqesë në mënyrë përshkimore të gjitha ankesat e depozituar pranë institucionit të konkurrencës dhe në pjesën e dytë të tij rastet e hetuara sipas shtyllave kryesore të ligjit.

II.1. Ankesat e biznesit

Rritja e rolit të Autoritetit të Konkurrencës në rivendosjen e konkurrencës në treg nëpërmjet instrumentave ligjorë të vendosjes së gjobave, masave të përkohshme, dhënies së rekomandimeve, rritja e advokacisë dhe kulturës, kanë rritur besimin e aktorëve të tregut tek Autoriteti. Ankesat e paraqitura pranë Autoritetit të Konkurrencës janë rritur nga viti në vit duke zgjeruar spektrin e tregjeve dhe praktikave antikonkurrese që janë vënë re në treg gjatë vitit 2011. Autoriteti ka ndjekur procedurat për 5 ankesa që janë objekt i ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” ndërkohë që ka adresuar pranë institucioneve përgjegjëse 9 ankesa të tjera. Trajtimi i ankesave është bërë në përputhje me parashikimet e ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Rregullores së Funkcionimit të Autoritetit dhe në të gjitha rastet është mbajtur një qëndrim proaktiv duke i dhënë përgjigje të gjithë ankimuesve dhe duke rritur në këtë mënyrë shkallën e besimit të biznesit te institucioni i Autoritetit të Konkurrencës



Grafik Nr 1: Numri i ankesave në vite



Grafik Nr 2: Ankesa që janë objekt i ligjit dhe të tjerë

II.1.1 Ankesat për kufizime të konkurrencës

Ankesa e Shoqatës Shqiptare të Bankave

Shoqates Shqiptare te Bankave ka sjellë pranë Autoritetit të Konkurrencës një ankesë lidhur me përjashtimin e bankave nga tregu i shërbimit të pagesës për regjistrimin në institucionet publike të arsimit të lartë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës Autoriteti i Konkurrencës u shpreh me anë të Vendimit Nr. 205, datë 14/11/2011 “Për një rekomandim për Ministrin e Arsimit dhe Shkencës për ndryshimin e udhëzimit nr. 36, dt. 9.9.2011 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 25, dt. 20.07.2011 ”Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë”.

Ankesat në tregun e shërbimit të ngarkim shkarkimit dhe depozitimit të GLN në Porto Romano

Ndërmarrja “Mare Oil” SHA në muajin Korrik 2011 ka paraqitur një ankesë pranë Autoritetit të Konkurrencës me anë të së cilës ka pretenduar se koncensionari “Romano Port” SHA nuk u lejonte të kryente shkarkimin e anijes me gaz të lëngshëm në Porto Romano në mënyrë të paarsyeshme dhe të pabazuar në ligj, pra ai nuk lejohet te depozitoje ne depozitat e veta. Bazuar në këtë ankesë, Autoriteti i Konkurrencës filloi në mënyrë të menjëhershme procedurën e monitorimit dhe të hetimit, të cilat do të paraqiten në seksionin e mëposhtëm.

Gjithashtu, edhe ndërmarrja “Prima Gas Albania” SHA më datë 12.08.2011 është ankuar pranë Autoritetit të Konkurrencës se nga ana e “Romano Port” SHA, nuk po lejohej shkarkimi i anijes së sjellë me gaz të lëngshëm, pasi i kërkonin edhe dokumenta të tjera shtesë.

Ndërsa, më datë 01.09.2011 ndërmarrja “Mare Oil” SHA depozitoi një ankesë tjetër, me pretendimin se, në datën 31 Gusht 2011, ishte penguar nga koncensionari për shkarkimin pranë Portit “Romano Port” të një anije me GLN. Shkaku i këtij refuzimi të realizimit të shërbimit ishte kërkesa për të nënshkruar një kontratë tip të llojit sipërmarrje (sipas kushteve të saj), për të bërë të mundur më pas shkarkimin e anijes.

Ankesa e ndërmarrjes në tregun e telekomunikacionit

Pranë Autoritetit të Konkurrencës një ndërmarrje që vepron në tregun e telekomunikacionit ka paraqitur një ankesë për ndërmarrjen Altelekom, me pretendimin se kompania me fuqi tregu aplikon tarifa më të larta për tregtimin e produktit interkoneksion për kartat me parapagesë krahasuar me të njëjtin shërbim që ndërmarrja Altelekom ofron me anë të kartës ALBLUE.

Pas shqyrtimit të kësaj ankese, Autoriteti i Konkurrencës vendosi hapjen e hetimit paraprak në tregun e ofrimit të kartave me parapagesë, procedurë e cila është në vazhdim.

Ankesa e shoqërisë së Shërbimit dhe të Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua një ankesë nga një ndërmarrje që vepron në tregun e shërbimit të ruajtjes dhe të sigurisë fizike për praktika antikurruese në prokurimet publike të këtij shërbimi. Procedurat e ndjekura në vijim të kësaj ankese do të paraqiten në seksionin e mëposhtëm.

II.1.2 Ankesat jashtë objektit të ligjit

Ankesa e ndërmarrjes AbCom

Pranë Autoritetit të Konkurrencës ndërmarrja AbCom ka paraqitur ankesën e saj në lidhje me disa veprime antikurruese të ndjekura nga ndërmarrja Tring në tregun e ofrimit të produktit internet. Pas shqyrtimit të kësaj ankese, u konkludua se ndërmarrja Tring nuk zotëron pozitë dominuese në tregun e ofrimit të internetit dhe si pasojë nuk mund të kufizojë konkurrencën në këtë treg.

Ankesa e ndërmarrjes Albanian Telecommunications Union

Pranë Autoritetit të Konkurrencës ndërmarrja “Albanian Telecommunications Union” Sh.p.k paraqiti ankesën e saj për dhënien me konçesion të rrjetit kombëtar me brez të gjerë në Republikën e Shqipërisë’ duke përjashtuar prej këtij konçesioni dhënien e rrjetit me brez të gjerë ne akset rrugore kombëtare, dhënë me Lejen Administrative Nr. 120, datë 23.08.2010 të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, me kundërshtëpërbllim shoqërisë Albanian Telecommunications Union Sh.p.k”.

Pas shqyrtimit të kësaj ankese u kontaktua se kjo ankese nuk është objekt shqyrtimi nga Autoriteti i Konkurrencës.

Ankesa e SINTEL Sh.p.k

Pranë Autoritetit të Konkurrencës ndërmarrja SINTEL Sh.p.k ka paraqitur ankesën e saj në të cilën shprehet se Altelekom Sh.a ka ushtruar presion për nënshkrimin e Ofertës së Re të Interkoneksioni dhe pretendon se kjo RIO nuk është miratuar nga AKEP. Gjithashtu nga operatori shprehet se në këtë dokument janë vendosur tarifa shumë të larta. Në lidhje me këtë ankesë Autoriteti i Konkurrencës ka kërkuar nga AKEP informacion më të plotë për vlerësimin ligjor të ankesës dhe është në pritje të këtij informacioni.

Ankesa e ndërmarrjes AMC sh.a

Pranë Autoritetit të Konkurrencës ndërmarrja “AMC” SHA, ka paraqitur një ankesë ku pretendon se operatori “Vodafone Albania” Sh.a është aktualisht duke ofruar për numrat e bartur paketa ofertash me çmime shumë të ulta.

Gjithashtu, ndërmarrja AMC, për të njejtën problematikë, është ankuar dhe për operatorin Eagle Mobile.

Pas shqyrtimit të kësaj ankese u konkludua se klientët kanë të drejtë të zgjedhin operatorin nga i cili duan të marrin shërbimin e telefonisë së lëvizshme dhe në çdo kohë mund të zgjidhin kontratën me një operator duke e lidhur me një tjetër, nëse kushtet e ofruara nga ky i fundit janë më favorizuese. Pra Autoriteti i Konkurrencës ka konkluduar se dhe kjo ankese nuk është objekt i Ligjit 'Për mbrojtjen e konkurrencës'.

Ankesa e ndërmarrjes Eagle Mobile

Pranë Autoritetit të Konkurrencës ndërmarrja Eagle Mobile ka paraqitur ankesën e saj për ndërmarrjen AMC sh.a. Me anë të kësaj ankese ndërmarrja Eagle Mobile shprehet se në adresën e kompanisë kanë shkuar shumë ankesa nga abonentët Eagle, të cilët ankohen për telefonatat e kryera nga ana e AMC-së pa marrë miratimin paraprak të abonentëve apo pavarësisht refuzimit të tyre për marrjen e këtyre telefonatave. Pas shqyrtimit të kësaj ankese u konkludua se kjo ankese nuk është objekt i Ligjit 'Për mbrojtjen e konkurrencës'.

Ankesa e ndërmarrjes Plus Communication

Pranë Autoritetit të Konkurrencës ndërmarrja Plus Communication ka paraqitur ankesën e saj për ndërmarrjen AMC sh.a. Me anë të ankesës së saj, ndërmarrja "Plus Communication" Sh.a, shpreh shqetësimin e saj lidhur me telefonatat e përsëritura dhe intensive të gjeneruara nga operatori "AMC" Sh.a për t'i tërhequr pajtimtarët e Plus nëpërmjet ofrimit të produkteve të 'AMC' sh.a. Pas shqyrtimit të kësaj ankese u konkludua se kjo ankese nuk është objekt i Ligjit 'Për mbrojtjen e konkurrencës'.

Ankesa e operatorit "Albanian Airline" sh.p.k

Operatori ajror "Albanian Airline" sh.p.k ka sjellë pranë Autoritetit të Konkurrencës një ankese në lidhje me Vendimin e Autoritetit të Aviacionit Civil për revokimin e Rinovimit të Çertifikatës së Operatorit Ajror (COA) për operatorin "Albanian Airline" sh.p.k.

Për një vlerësim sa më objektiv të kësaj kërkesë u zhvillua një takim me përfaqësues të "Albanian Airline" si dhe me anë të shkresës nr. 515 prot. dt. 23.12.2011 është kërkuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil informacioni përkatës mbi marrjen e vendimit objekt shqyrtimi, si dhe i është kërkuar realizimi i një takimi të përbashkët informativ mbi këtë situatë të krijuar. Autoriteti është në pritje të përgjigjes nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

Ankesa e ndërmarrjes "Philip Morris Albania" Sh.p.k

Ndërmarrja "Philip Morris Albania" Sh.p.k ka sjellë pranë Autoritetit të Konkurrencës një ankese lidhur me çmimet e referencës të aplikuara prej autoriteteve doganore shqiptare për disa nga produktet e "Philip Morris Albania" Sh.p.k.

Lidhur me këtë ankese u vlerësua e nevojshme që ankuesit t'i kërkohej plotësimi i Formularit Tip të Ankesës, dhe paraqitja e këtij Formulari pranë Autoritetit, proces i përcaktuar akoma.

Ankesa "Albaxeni" Sh.p.k.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës ndërmarrja “Albaxeni” Sh.p.k ka paraqitur ankesën e saj ndaj ndërmarrjes “Kurum International” SHA ku pretendon se ajo përcakton çmimet në treg për shitjen e hekurit për ndërtim dhe të çelikut; cakton çmimet e skrapit që grumbullon për kompanitë e tjera; është bërë pengesë kryesore në tregun e skrapit të hekurit pasi merr pjesë në ankande të ndryshme që organizohen për shitje skrapit, duke bërë një konkurrencë të pandershme; KURUM me anë të pjesëmarrjes në ankande, duke qenë se ka ofruar çmime më të larta, i ka mundur pjesëmarrësit e tjerë, gjë e cila është një konkurrencë e pandershme. Ankimuesi kërkon nga Autoriteti i Konkurrencës përjashtimin e kompanisë Kurum nga ankandet si proces i paligjshëm dhe moslejimin e pjesëmarrjes në ankand të ndërmarrjeve që kanë detyrime pa shlyer për ndërmarrjet e tjera.

Pas kontaktit me administruesin e kompanisë ju kërkua që të paraqitej për sqarime të mëtejshme dhe plotësimin e formularit të ankesës pranë Autoritetit të Konkurrencës. Ankimuesi nuk është paraqitur dhe për këtë arsye dokumenti i vetëm i administruar mbetet ankesa.

Në vlerësimin ligjor të kësaj ankese konstatojmë se është jashtë kompetencave të Autoritetit të Konkurrencës përjashtimi nga ankandi i shoqërive dhe procesi i likuidimit të borxheve mes tyre. Si konkluzion, kjo ankesë nuk përbën objekt të Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

II.2. Marrëveshjet e ndaluara (kartelet)

Ndalimi i marrëveshjeve e ndaluara ka qenë një ndër prioritetet kryesore të Autoritetit të Konkurrencës, sepse ato dëmtojnë mirëqenien sociale, krijojnë ineficencë dhe kalojnë mirëqenien nga konsumatorët tek pjesëmarrësit në marrëveshje.

Autoriteti i Konkurrencës ka realizuar monitorime dhe hetime, me synimin e zbulimit të marrëveshjeve apo të praktikave të koordinuara midis operatorëve në disa tregje, të cilat janë në vijim:

II.2.1 Hetimi në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në Qytetin e Vlorës

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, duke marrë shkas nga prononcimet në median vizive dhe të shkruar në lidhje me rritjen e çmimit të bukës në Qytetin e Vlorës, realizoi në mënyrë të menjëhershme një monitorim në Qytetin e Vlorës për të parë nëse kjo rritje çmimi kishte ardhur si rezultat i një marrëveshje të ndaluar midis operatorëve që operojnë në këtë treg. Nga monitorimi i realizuar u konstatua se rritja e çmimit të bukës në qytetin e Vlorës ka ardhur në mënyrë të menjëhershme, pas një mbledhje të prodhuesve dhe tregtuesve të bukës në qytetin e Vlorës, ku është rënë dakord se: *që nga data 23.03.2011 çmimi i bukës 900 gr do të jetë 120 lekë dhe çmimi i bukës 450 gr do të jetë 60 lekë.*

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në raportin e monitorimit, vendosi hapjen e hetimit paraprak si dhe marrjen e masave të përkohshme për ndalimin e kësaj marrëveshjeje të ndaluar për rritjen dhe fiksimin e çmimit të bukës në qytetin e Vlorës. Në vijim të procedurave u hap hetimi i thelluar në këtë treg.

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në raportin e hetimit të thelluar të hartuar nga Sekretariati, gjatë realizimit të të gjitha procedurave, si dhe pas degjimit të

palëve, vendosi gjobitjen e pjesëmarrësve në marrëveshje. Gjithashtu iu rekomandua Drejtorisë së Përgjithëshme të Tatimeve të evidentojë shkallën e lartë të informalitetit dhe përdorimin e kasave fiskale tek subjektet në këtë treg.

II.2.2 Hetimi paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në gjetjet gjatë monitorimit të nisura mbi bazën e një ankese ka vendosur hapjen e hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike ndaj një grup ndërmarrjesh që operojnë në tregun përkatës për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.

Metodologjia që përdoret gjatë hetimit është metodologjia që aplikon OECD për luftën ndaj koordinimit të ofertave në prokurimet publike, e cila është kthyer në një udhëzues për luftën ndaj marrëveshjeve në oferta në prokurimet publike. Ky udhëzues jep format e marrëveshjes së ndaluar midis ofertuesve, mënyrat se si ofruesit bien dakord të eliminojnë konkurrencën, listimin e karakteristikat që ndihmojnë marrëveshjen, reduktimin e koordinimit të sjelljes në procesin e prokurimeve, risku i tenderimeve me marrëveshje, ndërgjegjësimin e stafit të prokurimeve për ofertat me marrëveshje, etj.

Në zbatim të vendimit të Komisionit, Sekretariati po realizon procedurat hetimore në përputhje me Ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Kodin e Procedurave dhe Rregulloren e Procedurave Investigative. Në përfundim të procedurave, do të paraqesë pranë Komisionit të Konkurrencës raportin, ku do të analizohet sjellja e ndërmarrjeve nën hetim nëse vërtetohet ekzistenca e marrëveshjeve ndërmjet ndërmarrjeve.

II.3. Abuzimi me pozitën dominuese

II.3.1 Hetimi i thelluar në tregun e shërbimit, ngarkim- shkarkimit të GLN në Porto Romano

Komisioni i Konkurrencës bazuar në konkluzionet e nxjerra nga Sekretariati në shqyrtimin e ankesave dhe monitorimin e menjehershëm, me Vendimin Nr 196 datë 29.07.2011 vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të GLN-së në rrugë detare në Portin “Porto Romano”.

Duke marrë në konsideratë shkallën shumë të lartë të përqëndrimit në tregun e importit dhe të tregëtimit me shumicë të GLN-së, si dhe duke vlerësuar se moslejimi i shkarkimit të anijes së ndërmarrjes ankimuese mund të përbënte një shkak për një rrezik të kryerjes së një dëmi me pasoja të rënda e të pariparueshme për konkurrencën, Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin Nr. 197 datë 29.07.2011, vendosi të marrë masën e përkohshme duke urdhëruar ndërmarrjen “Porto Romano” SHA të bëjë të mundur përpunimin e anijes me GLN të sjellë nga ndërmarrja “Mare Oil” SHA, në mënyrë të menjehershme dhe jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga marrja e njoftimit të këtij vendimi. Ndërmarrja “Romano Port” ka ankimuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr 197 datë 29.07.2011, i cili vazhdon në proces gjyqësor.

Gjatë zhvillimit të fakteve të sipërpërmendura, ndërmarrja “Prima Gas Albania” SHA më datë 12.08.2011 është ankuar pranë Autoritetit të Konkurrencës

se, nga ana e “Romano Port” SHA nuk po lejohej përpunimi i anijes së sjellë me GLN nga ana e saj, pasi i kërkonin edhe këtij operatori dokumenta të tjera shtesë. Pas vlerësimit të ankesës, Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin Nr. 198, datë 25.08.2011 vendosi të marrë masën e përkohshme, duke urdhëruar ndërmarrjen “Romano Port” SHA të bëjë të mundur përpunimin e anijes me GLN të sjellë nga ndërmarrja “Prima Gas Albania” SHA në mënyrë të menjëhershme dhe jo më vonë se 5 ditë nga marrja dijeni e këtij vendimi.

Gjatë zhvillimit të procedurave hetimore, gjatë muajit Shtator 2011, u depozitua një ankese tjetër pasi dy ndërmarrjet “Prima Gaz Albania” SHA dhe “Mare Oil” SHA sërish u ishte kërkuar nga ana e koncesionarit që të nënshkruante një kontratë tip të llojit sipërmarrje, për të mundur shkarkimin e anijeve sipas kushteve të saj.

Në bazë të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Sekretariati gjatë periudhës së hetimit paraprak ka kryer inspektime në ndërmarrjet “Romano Port” SHA, “Prima Gas Albania” SHA si dhe ka zhvilluar takime pranë Autoritetit të Konkurrencës me ndërmarrjen “Mare Oil” SHA dhe “Prima Gas Albania” SHA.

Në vijim, Komisioni i Konkurrencës, pasi u njoh me gjetjet e raportit të hetimit paraprak, me Vendimin Nr. 201 datë 20.09.2011 ka hapur procedurën e hetimit të thelluar në tregun e shërbimit të ngarkim shkarkimit të gazit të lëngshëm të naftës në rrugë detare ndaj ndërmarrjes “Romano Port” SHA me objekt ekzistencën ose jo të abuzimit me pozitën dominuese në tregun përkatës.

Grupi i Punës pas përfundimit të procedurave të hetimit të thelluar hartoi raportin përfundimtar, ku nga vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjes “Romano Port” SH.A në tregun e ngarkim-shkarkimit të GLN, pretendohet se ajo ka vepruar në shkelje të nenit 9 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, duke vendosur kushte dhe/ose refuzuar ofrimin e shërbimit të ngarkim- shkarkimit të GLN si: (i) Pengim i tregtimit të produktit të subjekteve ankuese gjatë periudhës hetimore korrik 2011-15 shtator 2011, që operon në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të GLN, duke i refuzuar shkarkimin e anijeve me GLN gjatë periudhës hetimore, me pretendimin për paraqitjen e disa dokumenteve shtesë; (ii) Vendosja e kushtit për lidhjen e kontratave tip “Sipërmarrje për kryerje shërbimesh” ndaj dy subjekteve që operojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të GLN, duke i detyruar ato të pranojnë detyrime shtesë në mënyrë që të bëhet i mundur shkarkimin e anijeve të ardhura në muajin gusht 2011 e më pas, nga këto dy subjekte.

Aktualisht, Komisioni i Konkurrencës, para se të shprehet me vendimin final, ka organizuar seancën dëgjimore më palën objekt hetimi duke i krijuar mundësinë e njohjes me raportin e hetimit të thelluar dhe me dosjen hetimore, si dhe mundësinë e paraqitjes së pretendimeve të saj me shkrim dhe në mënyrë verbale para Komisionit.

II.3.2 Hetimit paraprak në tregun e ofrimit të kartave me parapagesë

Pas shqyrtimit të ankesës së operatorit “Alban Tirana Nacendo Al” dhe raportit të monitorimit të Sekretariatit, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 204, të datës 14.11.2011, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse me anë të kartave me parapagesë.

Ndërmarrja “Albtelecom” SHA ushtron veprimtarinë e saj në dy nivele të tregjeve, përkatësisht: në tregun me shumicë të origjinimit, terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetin Albtelecom , ku kjo ndërmarrje është shpallur operator me fuqi të ndjeshme në treg nga AKEP-i dhe tarifata e saj janë të

rregulluara; si dhe në tregun me pakicë, në atë të ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse me anë të kartave me parapagesë, i cili është një treg i parregulluar.

Ndërmarrja “Albtelecom” SHA zotëron 100% të tregut të aksesit (origjinim, terminim dhe tranzitim) për ofrimin e telefonisë fikse me kartat e parapaguara. Aktualisht të gjithë OSHKP-të, për të kryer veprimtarinë e tyre në ofrimin e kartave me parapagesë duhet domosdoshmërisht të përdorin rrjetin e Albtelecom për të kryer thirrjen. Aplikimi nga ana e ndërmarrjes “Albtelecom” SHA i çmimeve më të ulëta në nivelin e pakicës me anë të kartës ALBLUE, se çmimet e aplikuara nga ndërmarrjet e tjera që ushtrojnë veprimtari në ofrimin e kartave me parapagesë, mund të çojë në vendosjen në një gjendje të vështirë ose në daljen nga tregu të këtyre të fundit.

II.3.3 Hetimi paraprak në tregun e linjave, të shitjes me shumicë dhe pakicë, të aksesit për operatorët e telekomunikacioneve dhe përdoruesve fundorë

Autoritetit të Konkurrencës pasi është konsultuar me dokumentin e “Analizës së tregut të shumicës të aksesit broadband dhe aksesit në infrastrukturën fizike (LLU)” të AKEP-it, ka hapur me nismën e tij, me anë të Vendimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës Nr.10, datë 14.06.2011, procedurën e hetimit paraprak në lidhje me abuzimin e mundshëm me pozitën dominuese të “Albtelecom” SHA në tregun e linjave të shitjes me shumicë dhe me pakicë, të aksesit për operatorët e telekomunikacioneve dhe përdoruesve fundorë.

Në vijim të procedurës së hetimit, Grupi i Punës i ka kërkuar AKEP-it dhe ndërmarrjes Albtelecom SHA, si dhe të ndërmarrjeve që veprojnë në këtë treg, të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me mënyrën e tarifimit të linjave për shitjen me shumicë dhe me pakicë, si dhe numrin e klientëve, kopje të kontratave me operatorët, tarifatat e aplikuara nga Albtelecom etj.

Grupi i Punës pas përfundimit të procedurave të Hetimit Paraprak hartoi Raportin, ku nga analiza e konkurrencës rezultoi se Albtelecom zotëron pozite dominuese në tregun e linjave me qira me shumicë, me pakicë dhe në total. Në nivel me pakicë Albtelecom ofron kapacitete transmetimi në formën e linjave me qira si edhe linja të dedikuara urbane dhe shërbime LAN to LAN. Klientët kryesorë janë institucione financiare si banka, kompani me prezencë kombëtare si dhe institucione shtetërore. Nga analiza e këtij segmenti rezulton se blerësit me shumicë të shërbimit të linjave me qira të ofruara nga ndërmarrja Albtelecom SH.A, janë klientë fundor.

Për sektorin e telefonisë fikse dhe ofrimin e linjave me qira nuk ekzistojnë më pengesa ligjore për ofrimin e shërbimeve dhe rrjeteve fikse në shkallë kombëtare përfshirë zonat urbane. Në këtë treg operojnë një numër i madh operatorësh të tjerë privatë.

Tregu i Linjave me Qira është konturuar në një format të ri pas materialit të fundit që AKEP ka vendosur në konsultim me palët e interesit. Ky treg tashmë është i liberalizuar dhe në ridimensionim pas hyrjes në fuqi më 26.06.2008 e Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe kuadrit rregullator të tij, veçanërisht sistemi i Autorizimeve të Përgjithshme. Hyrja në fuqi e këtij Ligji ka hequr pengesat ligjore për ofrimin e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike në shkallë kombëtare që ekzistonin në Ligjin e mëparshëm.

Pas njohjes me Raportin e hetimit paraprak në “Tregun e linjave me qira”, në vazhdim të procedurave hetimore, Komisioni i Konkurrencës vendosi që të pezullohet procedura hetimore paraprake pasi ky rast kërkon një asistencë të specializuar në lidhje me çështjet teknike, duke vlerësuar karakteristikat dhe ndryshimet e vullshme që kanë ndodhur në këtë treg duke rimodeluar segmentet e tij .

II.3.4 Hetimi në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të produktit oriz, sheqer dhe në tregun e importit dhe të prodhimit të vajit vegjetal

Sikurse është raportuar në vitin e kaluar, Komisioni i Konkurrencës në fund të muajit tetor 2010, bazuar në raportet respektive të sekretariatit vendosi hapjen e hetimit paraprak në tregjet e importit dhe tregëtimit me shumicë të produktit oriz, sheqer dhe në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë së vajit vegjetal.

Në përfundim të procedurave hetimore, bazuar në sjelljet e firmave në tregjet respektive, dinamika e çmimeve, hyrjet në tregje, si dhe bazuar në analizën e kanaleve të shpërndarjes u konkludua se në tregjet objekt hetimi nuk u evidentuan shenja të kufizimit të konkurrencës për marrëveshje, apo praktikë të bashkërenduar, si dhe të abuzimit me pozitën dominuese, Komisioni i Konkurrencës vendosi: (a) mbylljen e hetimeve paraprake në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të produktit oriz, sheqer dhe në tregun e importit, prodhimit dhe tregëtimit me shumicë të vajit vegjetal, dhe; (b) vazhdimin e monitorimeve të këtyre tregjeve.

II.4. Monitorimet e tregut

Monitorimet realizohen kryesisht nga Sektori i analizës dhe i studimeve, duke realizuar detyrat e Komisionit të Konkurrencës sipas vendimeve respektive, apo duke marrë shkas nga indicio të cilat i shërbejnë departamentit të mbikëqyrjes së tregjeve për të vijuar procedurat hetimore.

II.4.1 Monitorimi i tregut të importit dhe prodhimit të grurit dhe miellit

Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit ka qenë vazhdimisht objekt i punës së Autoritetit të Konkurrencës për shkak të impaktit që sjell tek konsumatorët rritja e çmimit të bukës. Analiza e të dhënave të importit të grurit, siguruar periodikisht nga DPD, dhe informacioni mbi çmimin e shitjes së miellit i ardhur nga ndërmarrjet me të mëdha të shitjes së miellit të Tiranës, kanë qenë baza e të dhënave për vlerësimin e treguesve të konkurrencës në këtë treg. Analiza ka konsistuar në vlerësimin e çmimit të importit të grurit dhe shitjes së miellit si dhe ndryshimet strukturore në tregun e importit të grurit. Nga analiza e tregut nuk janë konstatuar shenja të kufizimit të konkurrencës, por tregu ende vazhdon të jetë objekt monitorimi.

II.4.2 Monitorimi i tregut të shërbimit të transportit detar për pasagjerët

Autoriteti i Konkurrencës, duke marrë shkas nga situata e krijuar në Portin e Vlorës gjatë 3 muajve të dytë të vitit në lidhje me shërbimin e transportit të

udhëtareve dhe mjeteve në tragetet e linjës Vlore –Brindisi dhe anasjelltas, filloi monitorimin në tregun e shërbimit të transportit detar për pasagjeret. Qëllimi i monitorimit ishte vlerësimi i sjelljes së operatoreve në tregun e transportit detar për të parë nëse kishte kufizime, shtrembërime apo pengesa për konkurrencën në treg. Duke qenë një treg i ri, realizimi i monitorimit u fokusua si në vlerësimin e bazës ligjore, ashtu edhe në vlerësimin e sjelljes së operatoreve në tregjet specifike të Durrësit, Vlorës dhe Sarandës. Në përfundim të monitorimit u konstatua se pezullimi i shërbimit nga ndërmarrjet që operojnë në portin e Vlorës u bë objekt vlerësimi nga Autoriteti Portual i Vlorës dhe u stabilizua nëpërmjet ndërhyrjes së këtij të fundit në kontratat dypalëshe.

II.4.3 Monitorimi i tregut farmaceutik

Tregu farmaceutik edhe gjatë vitit 2011 ka qenë objekt monitorimi dhe vlerësimi nga Autoriteti i Konkurrencës, bazuar në një shqetësim të përcjellë nëpërmjet një seance në Komisionin Ekonomik. Objektivi i këtij monitorimi ka qenë vlerësimi i procedurës së regjistrimit të barnave në Republikën e Shqipërisë dhe se si përdoret e drejta e tregtimit të barnave nga ndërmarrjet prodhuese farmaceutike në tregun shqiptar. Në përfundim të vlerësimit u konstatua se në këtë treg nuk ka elemente të abuzimit me të drejtën e tregtimit të barnave nga ndërmarrjet prodhuese farmaceutike ndaj kërkesës së ndërmarrjeve importuese për furnizim.

II.5. Përqëndrimet

Gjatë vitit 2011, është vënë re rritja e numrit të përqëndrimeve të njoftuara pranë Autoritetit për marrjen e autorizimit nga ana e Komisionit të Konkurrencës. Ky ndryshim vjen si pasojë e uljes së pragut të xhiros së ndërmarrjeve objekt përqëndrimi që kanë detyrimin ligjor për marrjen e autorizimit të Komisionit të Konkurrencës. Ndërkohë në kuadër të mbikëqyrjes së tregut, Autoriteti i Konkurrencës pasi ka administruar të gjithë databasen nga QKR-ja dhe ka filluar me nismën e tij procedurat për njoftimin e të gjitha rasteve që përmbushin kriteret ligjore për t'u autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës, por që nuk janë njoftuar nga palët.

Gjatë vitit 2011 janë shqyrtuar dhe autorizuar 10 praktika përqëndrimesh lidhur me përfundimin e kontrollit, bashkimin e ndërmarrjeve apo krijimin e një ndërmarrje të re, krahasuar me 6 raste përqëndrimesh në 2010. Përqëndrimet e ndodhura janë shqyrtuar si për efektet pozitive të sjella në treg, porë kjo nga pikëpamja e konsumatorit dhe rritjes së efikasitetit në treg, ashtu edhe nga premiset e mundshme për të krijuar apo forcuar pozitën dominuese të ndërmarrjes së përqëndruar në treg. Karakteristikat kryesore të procedurave të përqëndrimeve janë pasqyruar në Shoqjen nr.4.

Në mënyrë të përmbledhur dinamika e karakteristikave të transaksioneve që kanë qënë objekt kontrolli nga Autoriteti i Konkurrencës për 2010 dhe 2011 jepen në tabelën e mëposhtme:

Ndryshimi i kontrollit si pasojë:	Nr. i përqendrimeve të autorizuarra gjatë 2011-ës	Nr. i përqendrimeve të autorizuarra gjatë 2010-ës
Bashkim i dy ose më shumë ndërmarrjeve ose pjesë ndërmarrjesh të pavarura nga njëra tjetra	1	0
Përfitim kontrolli (i drejtpërdrejtë ose i tërthortë) të një ose më shumë ndërmarrjeve ose të një pjese të kësaj të fundit	9	5
Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët, që kryen të gjitha funksionet e një njësie ekonomike të pavarur – Joint Venture	0	1
Totali	10	6

i. Bashkim i dy ose më shumë ndërmarrjeve ose pjesë ndërmarrjesh të pavarura nga njëra tjetra

Nga përqendrimet e autorizuarra nga Komisioni i Konkurrencës u analizua rasti i vetëm i bashkimit me përthithje ndërmjet bankave "Alpha Bank S.A / EFG Eurobank Ergasias S.A". Ky transaksion nuk solli ndryshim të strukturës së tregut bankar në Shqipëri pasi, Eurobank nuk ishte prezent në Shqipëri me asnjë filial, degë, shoqëri të lidhur apo asete (apo ndonje formë tjetër aktiviteti). Përqendrimi në fjalë u autorizua me Vendimin Nr. 206, datë 18.11.2011, "Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit me përthithje të Alpha Bank S.A dhe EFG Eurobank Ergasias S.A" pasi ky transaksion nuk krijonte apo forconte pozitën dominuese të ndërmarrjes në treg.

ii. Përfitim kontrolli (i drejtpërdrejtë ose i tërthortë) i një ose më shumë ndërmarrjeve ose të një pjese të kësaj të fundit

Në tregun e shitjes së automjeteve të reja, gjatë 2011, janë realizuar dy përqendrime nëpërmjet përfimit të kontrollit nga e njëjta ndërmarrje përthithëse, Auto Master SHA. Nga analiza e kryer, përqendrimet e autorizuarra nga Komisioni i Konkurrencës të ndodhura ndërmjet **Auto Master SHA/Tirana Auto Shpk** dhe **Auto Master SHA /Tirana Auto Shpk** me vendimet përkatëse Nr. 169, dhe Nr. 170, datë 07.01.2011 rezultuan se nuk krijonin apo forconin pozitën dominuese të ndërmarrjes Auto Master SHA në tregun përkatës të produktit.

Si pasojë e përfimit të kontrollit, në fushën e pensioneve private vullnetare janë shqyrtuar dy raste përqendrimi. Përqendrimi i parë i realizuar mes ndërmarrjeve **Sigal Life Uniqa Group Austria Sha** dhe **Capital SHA** u autorizua nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 183, datë 29.03.2011, "Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shit-blerjes së 51% të aksioneve të shoqërisë Capital SHA nga shoqëria Sigal Life Uniqa Group Austria SHA". Përqendrimi nuk ndryshonte strukturën e përgjithshme të tregut të pensioneve private vullnetare në Shqipëri, pasi ai lidhej vetëm me ndryshimin e strukturës së zotërimit të aksioneve brenda shoqërisë "Capital". Përqendrimi i realizuar nuk shfaqte shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të shoqërisë Sigal Life Uniqa Group Austria SHA.

Rasti i dytë në tregun e pensioneve private vullnetare i ndodhur mes ndërmarrjeve **SICRED SHA** dhe **SIGMA I.P.P SHA**, u autorizua nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 186, datë 12.04.2011. Nga analiza e kryer, rezultoi se dy shoqëritë vepronin në tregje të ndryshme të produktit. Ky përqendrim nuk ndryshonte strukturën e përgjithshme të tregut të pensioneve private vullnetare në Shqipëri, pasi ky transaksion lidhej vetëm me ndryshimin e strukturës së zotërimit të aksioneve brenda shoqërisë "Sigma I.P.P".

Vendimi Nr. 188, datë 26.05.2011, "Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shit-blerjes së 100% të aksioneve të shoqërisë **Delta Max d.o.o Serbia**, nga shoqëria Hitomi Finacial Limited tek shoqëria **Delhaize "The Lion" Nederland B.V**". Delta Maxi në Shqipëri zotëronte në masën 100% shoqërinë Euromax Sh.p.k. Përqendrimi nuk sillte asnjë ndryshim në pjesën e tregut që zinte shoqëria Euromax Shpk pasi përfituesi i kontrollit nuk ishte prezent në tregun shqiptar para përqendrimit dhe për pasojë nuk ndryshonte struktura e tij pas përqendrimit. Gjithashtu, ky transaksion nuk shkaktonte krijimin apo forcimin e pozitës dominuese të shoqërisë Euromax në tregun përkatës.

Përqendrimi nëpërmjet përfutimit të kontrollit në shoqërinë **Man SE** nga **Volkswagen Aktiengesellschaft**, u autorizua nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 195, datë 22.07.2011, "Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të 55.9 % të të drejtave të votës dhe 53.71 % të kapitalit themeltar nga shoqëria Volkswagen Aktiengesellschaft tek shoqëria MAN SE". Analiza e kryer tregoi se nuk kishte mbivendosje të veprimtarive ekonomike të palëve në Shqipëri, si pasojë as tregje të prekur nga ky transaksion. Realizimi i këtij transaksioni nuk pritej të kishte ndonjë ndikim në tregun e brendshëm dhe as të shkaktonte krijimin apo forcimin e pozitës dominuese të shoqërisë pas përqendrimit.

Në 2011, në tregun e sigurimeve u realizua përqendrimi i realizuar mes ndërmarrjeve **Vienna Insurance Group AG** dhe **Intersig Sh.a**, i cili u autorizua nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 199, datë 15.09.2011, "Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 75%+1 aksione të shoqërisë Intersig SHA nga shoqëria Vienna Insurance Group AG". Duke patur parasysh faktin se para përqendrimit Vienna Insurance Group zotëronte paketën kontrolluese të aksioneve në shoqërinë Sigma. SHA dhe Interlbanian SHA, u analizuan tregjet e prekura në tregun shqiptar të sigurimeve kryesisht në tre nëntregje të sigurimeve të jo-jetës si tregu i sigurimeve motorrike, tregu i sigurimit të pasurisë dhe tregu i sigurimit të shëndetit. Në rastin e përqendrimit VIG-Intersig SHA, pjesët e kombinuara të tregut ishin më pak se 40 % në dy nëntregje (sigurimi i pasurisë dhe sigurimi i shëndetit) dhe kishte pjesë të përafërta tregu me pjesën e kombinuar Sigma-Interlbanian në nëntregun e sigurimit të shëndetit. Pas realizimit të përqendrimit VIG-Intersig, kompania lider në treg Sigal pritet të sfidohet nga Vienna International Group duke krijuar një konkurrencë bipolare në tregun e sigurimit.

Përfutimi i plotë i kontrollit nga **Japan Tobacco Group (Japoni)** të **Haggar Cigarette&Tobacco Factory Ltd.** nëpërmjet blerjes së 100% të kuotave, u autorizua nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 200, datë 15.09.2011, pasi transaksioni nuk kishte asnjë efekt në tregun shqiptar dhe nuk sillte krijim apo

forcim të pozitës dominuese në tregun e brendshëm për ndërmarrjet objekt përqendrimi.

Vendimi 208, datë 05.12.2011, "Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar ndërmjet shoqërive **XLWorld Europe S.r.l** dhe **Xerox S.p.a** me qëllim përfundimin e shoqërive **Eagle Connect Sh.p.k** dhe **Voice Star Sh.p.k**". Gjatë vlerësimit të këtij transaksioni u konstatua se transaksioni nuk do të kishte efekte negative mbi konkurrencën apo konkurrentët në Shqipëri pasi Voice Star Shpk dhe Eagle Connect Shpk zotërohen nga e njëjta shoqëri dhe as blerësi apo shoqëria mëmë nuk janë aktivë në tregun shqiptar. Transaksioni nuk shkaktonte mbivendosje të aktivitetit të palëve në nivel horizontal dhe as forcim të pozicionit të shoqërive Eagle Connect dhe Voice Star në treg.

Raste të shqyrtuara që nuk janë konsideruar objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës

Në kuadër të nenit 6 të "Rregullores për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve", gjatë vitit 2011, pranë Autoritetit të Konkurrencës janë paraqitur 9 raste transaksionesh të cilat nuk janë konsideruar objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës si pasojë e mospërmbushjes së kriterëve të nenit 10 ose 12 e Ligjit "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshimit të kontrollit të ndërmarrjeve objekt përqendrimi apo të mospërmbushjes së kushtit të xhiros minimale të parashikuara në ligj.

Në tregun bankar :

Transaksioni i shitjes së aksioneve të shoqërisë **Akif Bank A.S** (perkatesisht 24%) tek shoqëria **Calik Holding A.S** dhe 1 aksion tek shoqëria **Gap Guneydogu Tekstil Sanayi ve Ticaret A.S** u realizua në formën e zëvendësimit të pronësive së aksioneve në shoqërinë CFH ku aksioneri maxhoritar i saj Calik Holding rriste pronësinë nga 75% në 99.99%, pa e ndryshuar strukturën e kontrollit në BKT, pasi kjo e fundit vazhdonte të zotërohej nga CFH.

Transferimi i 100% të aksioneve të rrjetit bankar të zotëruara nga shoqëria Raiffeisen Bank International AG ('RBI') tek shoqëria Raiffeisen SEE Region Holding GmbH ('SEE Holding'), filial i zotëruar 100% në mënyrë indirekte nga RBI, konsistonte në një ndryshim cilësor të kontrollit të shoqërisë shqiptare Raiffeisen Bank Sh.a, nga ai i drejtpërdrejtë në kontroll indirekt nga shoqëria RBI (nëpërmjet SEE Holding). Meqenëse shoqëria SEE Holding vetë zotërohet nga RBI atëherë ky transaksion përbën një ristrukturim brenda grupit. Për pasojë ky transaksion nuk përbente objekt për dhënie autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Transaksioni i realizuar ndërmjet Credit Agricole S.A dhe Sacam International S.A.S për veprim e bashkëpunim, në lidhje me oferten publike vullnetare për marrjen në zotërim të 4% aksioneve të listuara në bursë te Emporiki Bank of Greece S.A nga Credit Agricole S.A", nuk përbente një përqendrim në baze të nenit 10 të Ligjit Nr. 9121, datë 27.08.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" (të ndryshuar) pasi nuk kishte ndryshim në cilësinë e kontrollit në Emporiki Bank of Greece S.A ku Credit Agricole S.A kishte kontrollin në këtë të fundit. Gjithashtu ai nuk shkaktonte asnjë efekt në tregun financiar shqiptar, ku Emporiki Bank of Greece S.A zotëron Emporiki Bank of Albania.

Në sektorin e telekomunikacioneve

Bashkimi Albtelekom-Eagle Mobile: Bashkimi i shoqërive Albtelecom SHA dhe Eagle Mobile SHA ishte një transaksion i vlerësuar nga Autoriteti i Konkurrencës për efektet e mundshme që mund të shkaktonte në treg, por që nuk ishte objekt për dhënie autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Sipas vlerësimit ligjor, meqenëse shoqëria target i transaksionit të pritshëm (Eagle Mobile) zotërohet në masën 100% nga shoqëria përthithëse (Albtelecom) atëherë transaksioni i pritshëm, i cili konsistonte në një ndryshim të strukturës organizative/menaxhariale të të dy shoqërive pjesëmarrëse dhe jo në një ndryshim cilësor të kontrollit në shoqërinë Eagle Mobile. Bashkimi operacional mes Albtelekom SHA dhe Eagle Mobile SHA në kuptim të nenit 10, pika 1, a) nuk përbën përqëndrim që duhet t'i nënshtrohet procedurës së kontrollit dhe autorizimit nga ana e Komisionit të Konkurrencës për shkak se ndërmarrjet nuk janë të pavarura nga njëra-tjetra, por kontrollohen dhe janë pjesë e të njëjtit grup, Çalik Holding.

Gjithësesi meqenëse pas bashkimit priten ndryshime strukturore të rëndësishme në tregun e telekomunikacioneve, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 210, të datës 21.12.2011 i ka dhënë disa rekomandime AKEP që në autorizimin përkatës të kërkojë nga shoqëria pas bashkimit kryesisht ndarjen e llogarive për telefoninë fikse dhe atë të lëvizshme, e cila do të bëjë të mundur rritjen e transparencës dhe mos abuzimin me poziten dominuese të operatorit me fuqi tregu.

Ristrukturimi i Vodafone; Në tjetër transaksion në këtë sektor ishte transferimi i 50% të aksioneve të Vodafone Albania SHA tek aksioneri tjetër ekzistues shoqëria Vodafone Europe (50%). Pas këtij transaksioni, pronësia e aksioneve të shoqërisë Vodafone Albania do të zotërohej 100% vetëm nga njëri prej aksionerëve të saj, shoqëria Vodafone Europe. Transaksioni konsistonte në një ndryshim cilësor të kontrollit, nga ai i përbashkët (Vodafone Panafon dhe Vodafon Europe) në kontroll të vetëm (Vodafone Europe) në shoqërinë shqiptare Vodafone Albania. Meqenëse të dy aksionerët e Vodafone Albania ishin pjesë e të njëjtit grup, Vodafone Group Plc, ky transaksion përbënte një restrukturim brenda grupit. Pra transaksioni i pritshëm në bazë të nenit 10 pika 1 shkronja b) e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" i ndryshuar (Ligji), nuk përbën një përqëndrim.

Në sektorin e energjisë

Transaksioni te Energji Ashta: Shoqëritë zotëruese të Energji Ashta Sh.p.k, Verbund dhe EVN planifikonin një strukturë të re në zotërimet e kapitalit të Energji Ashta Sh.p.k. Sipas kësaj strukture, planifikohej që të gjitha kuotat e Energji Ashta Sh.p.k të kalonin si kontribut në kapitalin e shoqërive holding, të krijuara enkas për këtë qëllim. Zotërimi i kuotave në të dyja shoqëritë holding do të ishte perkatesisht 51% nga Verbund dhe 49% nga EVN, pra në të njëjtën masë si edhe te Energji Ashta Sh.p.k. Sipas strukturës së planifikuar Verbund do të vazhdonte të mbante kontrollin mbi drejtimin industrial për realizimin e projekteve të centralit elektrik si dhe drejtimin e Energji Ashta Sh.p.k. Struktura e re e shoqërive holding nuk përbën një ndryshim të strukturës së kontrollit të Energji Ashta Sh.p.k. Ky transaksion u realizua në brendësi

të Grupit Verbund AG dhe nuk sillte asnjë pasojë në strukturën e tregut apo cilesinë e kontrollit të shoqërisë Energji Ashta Sh.p.k.

Para-njoftimi i blerjes së aseteve të shoqërisë Sofigas Sh.p.k nga shoqëria Messer Albagass Sh.p.k” u vlerësua si një përfitim kontrolli i drejtperdrejte me anë të transferimit të aseteve nga shoqëria Sofigas tek shoqëria Messer Albagas, i cili ishte përqëndrim në kuptim të nenit 10, por nuk plotësonte kufijtë e xhiros sipas nenit 12 pika 1 të Ligjit, dhe për pasojë nuk ishte objekt për dhënien e autorizimit nga Komisioni Konkurrencës.

Në sektorin ushqimor: Sektori i Përqendrimeve, me iniciativën e tij, ka vlerësuar bashkimin e shoqërive me anë të transferimit të 100% të kuotave të shoqërisë OERT Sh.p.k tek shoqëria Sucralba Sh.p.k. Nga vlerësimi ligjor ky transaksion ishte një bashkim me përthithje i shoqërisë OERT Sh.p.k me shoqërinë Sucralba Sh.p.k. Duke qenë se të dyja shoqëritë zotëroheshin nga i njëjti ortak ky operacion *nuk u konsiderua përqëndrim në kuptim të nenit 10* dhe pse plotësonte kufijtë e xhiros sipas nenit 12 pika 1 të Ligjit dhe për pasojë nuk ishte objekt për autorizim, i cili duhej të njoftohej pranë Autoritetit të Konkurrencës.

II.6 Rishikimi gjyqësor dhe ekzekutimi i vendimeve të Komisionit të Konkurrencës.

Gjatë vitit 2011, Autoriteti i Konkurrencës ka ndjekur procedurat gjyqësore lidhur me çështjet e ankimuar pranë Gjykatave përkatëse në lidhje me vendimet e Komisionit të Konkurrencës. Ndryshe nga vitet e mëparshme ku vendimet e Komisionit të Konkurrencës ankimoheshin përgjithësisht për procedurën e ndjekur nga Autoriteti, gjatë vitit 2011 ka një ndryshim thelbësor të ankimeve pasi tashmë palët janë ndërgjegjësuar për rolin e Ligjit dhe Autoritetit të Konkurrencës.

Paditë e gjykuara dhe mbrojtja ligjore në gjykatë tashmë i referohet më së shumti thelbit të çështjes, shkeljeve të parashikuara në ligj, abuzimit me pozitën dominuese, marrëveshjeve të ndaluara dhe mosnjoftimi i përqendrimeve sipas afatit të përcaktuar. Edhe vendimmarrja e sistemit gjyqësor ka ndryshime pozitive në argumentimin pasi ka tejkaluar fazën e fokusit vetëm te procedurat duke analizuar sjelljet antikonkurrese në kuptim të ligjit të konkurrencës, si psh në rastet e abuzimit me pozitën dominuese, ngjeshja e çmimit, çmimet grabitqare, refuzimi për të tregtuar etj., si dhe në interpretimin e marrëveshjeve të ndaluara si rastet e marrëveshjeve në oferta në prokurimet publike, fiksimi i çmimeve dhe ndarja e tregut etj..

Nga procesi i rishikimit gjyqësor, gjykatat kanë konfirmuar dhe tashmë janë vendime të formës së prerë 8 (nga 120) vendimeve të Komisionit të Konkurrencës që tashmë janë në procedurë ekzekutimi nga zyra e përmbartimit gjyqësor Tiranë. Për dy vendime të Komisionit të Konkurrencës vazhdojnë procedurat e shqyrtimit gjyqësor. Në dy raste të tjera gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë ka rrëzuar vendimet e Komisionit të Konkurrencës, por tashmë këto vendime janë apeluar në shkallën më të lartë të gjyqësorit. Një përmbledhje e statusit të rishikimit gjyqësor të Vendimeve të Komisionit të Konkurrencës paraqitet në Shtojcën 5 dhe 6.

Autoriteti i Konkurrencës, në zbatim të nenit 80 të Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, dhe në zbatim të Kodit të Procedurës Civile, ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e duhur për të bërë të mundur ekzekutimin e titujve ekzekutivë nga ana e Zyrës së Përmbarimit, te cilat i përkasin 7 (shtatë) Vendimeve të Komisionit të Konkurrencës

III. Advokatia dhe kultura e konkurrencës

Advokatia dhe kultura e konkurrencës janë dy pjesë të një binomi shumë të rëndësishëm për shkallën e zbatimit të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe të Politikës Kombëtare të Konkurrencës, pasi përfshijnë edhe faktorët edhe aktorët e lojës në treg. Mirë funksionimi i tregjeve kërkon që të rrespektohen parimet e tregut të lirë si nga ana e enteve rregullatore dhe institucioneve publike, të cilat mund të sjellin deformime nëpërmjet akteve të ndryshme normative, apo praktikave të punonjësve të tyre, ashtu edhe nga komuniteti i biznesit, i cili duhet të jetë shumë proaktiv në luftën ndaj praktikave antikonkurruese.

III.1. Advokatia e konkurrencës

Promovimi dhe advokacia e konkurrencës përbën një nga shtyllat e tjera të zbatimit të ligjit, rritja e forcës zbatuese e të cilit ka qënë një nga objektivat e vitit të kaluar, realizimi i të cilit është mundësuar nëpërmjet përsosjes së instrumentave për nxitjen e bashkëpunimit me institucionet e tjera qëndrore dhe entet rregullatore dhe forcimin e rolit proaktiv të Autoritetit të Konkurrencës për respektimin e lirisë ekonomike.

III.1. 1. Vlerësimi i akteve dhe draft-akte normative

Krahasuar me vitin 2010 vihet re së gjatë vitit 2011 është rritur numri i akteve nënligjore të sjella për mendim nga institucionet shtetërore pranë Autoritetit të Konkurrencës. Ky është një tregues domethenës i lidhur me rritjen e ndjeshmerisë së institucioneve ndaj hartimit të projekt-akteve sa me në favor të konkurrencës. Gjatë vitit 2011 Komisioni i Konkurrencës ka marrë një sërë vendimesh për dhënie rekomandimesh për disa p/akte me ndikim në tregje të ndryshme. Një përmlendhje e të gjitha vlerësimeve të kryera nga Autoriteti i Konkurrencës paraqiten në Shojcën nr. 7. Më kryesoret janë:

- 1) Me Vendimin nr. 174, datë 25.01.2011 Komisioni i Konkurrencës (VKK) ka dhënë rekomandime lidhur me transparencën dhe komisionet e aplikuara në tregun e shërbimeve bankare, si elemente probabiliteti përzgjedhës për klientët dhe që rritin konkurrencën në treg. I është rekomanduar institucioneve shtetërore (BSH dhe Komisionit të Mbrojtjes Konsumatore), që të përmirësojnë instrumentet e zbatimit të kuadrit normativ mbi transparencën e bankave të nivelit të dytë, (veçanërisht në rastet kur ato rrisin njëanshmërisht, pa njoftuar, tarifat e shërbimeve për klientët), duke marrë masa për rritjen e transparencës së tyre nëpërmjet detyrimit për krijimin dhe përditësimin e informacionit në faqet e tyre të internetit, lidhur me publikimin e kushteve të punës dhe ofrimit të shërbimit. Po kështu u është propozuar ideja për ngritjen e Ombudsmanit si mbrojtës i konsumatorëve nga abuzimet në sistemin bankar.
- 2) Me VKK Nr.177, datë 25.02.2011, i është rekomanduar ERE që në rregulloren “Për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit” të saktësohet kohëzgjatja e “periudhës tranzitore” dhe kushti përkatës me të cilin do të përfundojë kjo

periudhë, si dhe të precizohen ofertat për tregun pas periudhës tranzitore, me qëllim që operatorët të konkurrojnë duke ndikuar drejtpërdrejtë në përfitimet tarifore të klientit. Po ashtu ju propozua që të mos ketë kufizime lidhur me numrin e ofertave për zhvillimin e ankandeve, t'u jepet prioritet kërkesave për plotësimin e nevojave për transmetim & interkonjeksion, si dhe të parashikohet veçanërisht mënyra e përbalimit të situatave emergjente hidro-energjetike.

- 3) Me VKK Nr. 178, datë 25.02.2011, i rekomandoi ERE ndryshime në rregulloren e procedurave të blerjes së energjisë elektrike prej KESH sh.a, ose nga tregtarët vendas e të huaj. Këto ndryshime konsistojnë në përcaktimin e rregullores në: "Rregullorja e procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi Publik me Shumicë dhe nga tregtarët vendas dhe të huaj"; ndryshimin e autoritetit blerës së energjisë elektrike prej tyre për diferencat e sasive të energjisë elektrike nga KESH sh.a me Furnizuesin Publik me Shumicë, si dhe zëvendësimin e KESH sh.a me "Furnizues Publik me Shumicë" në të gjithë rregulloren.
- 4) Me VKK Nr. 205, datë 14.11.2011 i ka rekomanduar Ministrit të Arsimit dhe Shkencës lidhur me amendimet e tij mbi Udhëzimin nr. 25, datë 20.07.2001 për ndryshimin e udhëzimit në fjalë me qëllim shmangien e kufizimeve të konkurrencës në tregun e shërbimeve financiare, si dhe dhënien e mundësisë që pagesat e regjistrimit për studime të kryhen si prej Postës Shqiptare, ashtu edhe nga bankat e nivelit të dytë.
- 5) Komisioni i Konkurrencës me Vendimit Nr. 210, dt. 21.12.2011, bazuar në ndikimin në konkurrencë të bashkimit mes Albtelecom Sh.A. dhe "Eagle Mobile", i ka rekomanduar AKEP, që në autorizim të kërkojë nga shoqëria e përftuar, ndarjen e llogarive për telefoninë fikse dhe atë të lëvizshme duke mundësuar verifikimin e burimit të gjenerimit të të ardhurave për të siguruar mosdiskriminimin ndaj operatorëve konkurrentë të Eagle Mobile në telefoninë e lëvizshme, prej OFNT në telefoninë fikse Albtelecom Gjithashtu shoqërisë së përftuar ti kërkohet transparencë; detyrimi për akses dhe interkoneksion nga përdorimi i përbashkët i lehtësirave të tregut përkatës; si dhe në rastin e ofertave të përbashkëta mes segmenteve të tregut të telefonise fikse, celulare dhe shërbimit të internetit, operatori duhet të marrë miratimin e AKEP në mënyrë që të mbrohet përdoruesi fundor.

Lidhur me këtë pikë, të vlerësimit të akteve ose projekt/akteve normative, të paraqitura për mendim, janë kryer vlerësimet juridike nisur nga këndvështrimi i ligjit 9121 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Konkretisht mund të rradhitim këto vlerësime sa më poshtë vijon:

- 1) Vlerësim juridik mbi Projekt-rregulloret: "Për cilësinë e shërbimit të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike" dhe Projekt-kontratës "Furnizimit me energji elektrike për konsumatorët tariforë". Lidhur me këto akte Autoriteti i Konkurrencës është shprehur në parim dakord, por njëkohësisht ka propozuar disa ndryshime në draftet e paraqitura lidhur me: transparencën e çmimit dhe vlerësimit të konsumuar; dëmshpërblimin e klienteve; vënien e gjobave për furnizuesin, (në rast mos paraqitje të faturës brenda kushteve të përcaktuara në kontratë); etj., si dhe

përcaktimin saktësisht të parametrave të cilesisë së tensionit në bazë të të cilit lejohet shmangia.

- 2) Vlerësim ligjor mbi projekt-kontratën “Për shërbimin e kontrollit fillestar dhe atij periodik të aparatit matës”. Lidhur me këtë projekt-kontratë Autoriteti i Konkurrencës është shprehur se nuk bie në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Gjithsesi për një qartësim dhe harmonizim më të mirë të dispozitave janë dhënë disa sugjerime si: e drejta e kontraktorit mbi ndryshimin e njëanshëm të tarifave; bërja e riformulimit dhe/ose rishikimit të disa përkufizimeve, pasi rezultojnë të paqarta, ose të përsëritura.
- 3) Dhënie mendimi mbi p/vendimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore mbi “Planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për kryerjen nga Posta Shqiptare SHA të shërbimeve postare, financiare dhe shërbimeve të tjera, që janë në përputhje me aktivitetin e “Posta Shqiptare” SHA. Komisioni i Konkurrencës është shprehur pjesërisht lidhur me këtë projekt-vendimin duke qenë parimisht dakord, por duke rekomanduar të rishikohet afati 5 vjeçar për dhënien e ndihmës, me synimin mbajtjen parasysht të zotimeve në favor të një procesi sa më të shpejtë të liberalizimit të shërbimit postar; si dhe marrja parasysht e interesave të palëve që mund të preken nga ky vendim.
- 4) Vlerësim juridik mbi p/rregulloren “Për kriteret e dhënies,ose heqjes së statusit të klientit të kualifikuar” ku pasi ka shprehur miratimin për p/rregulloren e paraqitur si në përputhje me ligjin nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Autoriteti i Konkurrencës ka propozuar që në të të përcaktohen detyrimet, tarifat, kushtet e shërbimeve, apo elemente të tjera teknike me qëllim bërjen efektive dhe funksionimin normal të Klientit të Kualifikuar.
- 5) Autoriteti i Konkurrencës është shprehur edhe mbi p/rregulloren “Për miratimin e lidhjeve të reja në sistemin e shpërndarjes” dhe “Marrëveshjes për lidhjen e re”, drejtuar ERE. Lidhur me këtë të fundit AK është shprehur se duhet të ndahet dhe të përcaktohet qartë roli dhe funksioni i OSSH dhe Furnizuesit me Pakicë e Publikut, me qëllim që ta bëjnë sa më funksional dhe konkurrues tregun e energjise elektrike.
- 6) Dhënie mendimi mbi kërkesën e ERE “Për një ndryshim në Rregullat e Alokimit të Kapaciteteve të Interkoneksionit”. Lidhur me këtë ndryshin Autoriteti i Konkurrencës është shprehur se: përsa i përket pretendimeve në lidhje me arsyet teknike të paraqitura nga palët, është ERE organi kompetent që do të bëjë vlerësimin e drejtë të situatës. Gjithashtu, autoriteti kërkon që përmirësimi i kapaciteteve të ndërlidhjes dhe ndryshimet pozitive të ndodhura, të garantojnë aksesin mbi baza jo-diskriminuese, transparente dhe konkurruese të të gjithë operatorëve të licensuar në tregun e energjisë elektrike.
- 7) Dhënie mendimi mbi aplikimin e paraqitur për përjashtimin e aksesit të palëve të treta ndaj projektit Trans-Adriatic-Pipeline (TAP). Në vlerësimin drejtuar ERE, Autoriteti i Konkurrencës shprehet në parim se: përjashtimet

e kërkuara në aplikimin në fjalë mund të çojnë edhe drejt një kufizimi të konkurrencës, por bazuar në konsultimin me ekspertët e projektit IPA 2008, institucioni i konkurrencës ka sugjerur: mundësinë e shkurtimeve të afatit të përjashtimit të palëve të treta nga aksesit; dhënien pjesore të duke u lënë një % të lirë për akses palëve të treta në tregun vendas, si dhe, parashikimin në projekt të *pikave dalëse*, me qëllim mundsimin në cdo kohë të përfitimit nga tregu vendas.

- 8) Vlerësim ligjor mbi projekt-Ligjin “Për burimet e energjisë së rinovueshme”. Në vlerësimin e tij Autoriteti i Konkurrencës ka shprehur rezerva konkrete në lidhje me ato dispozita të Projektligjit, të cilat mund të sjellin kufizime të konkurrencës efektive në këtë segment tregu (neni 17), ndaj ka rekomanduar që në p/Ligj të përcaktohet qartë detyrimi që tarifatat e transmetimit dhe shpërndarjes të jenë jo-diskriminuese për prodhuesit dhe përfituesit, si dhe mosdiskriminim për shkak të vendndodhjes, apo sasisë së ulët të energjisë. Projekt-Ligji duhet të përcaktojë se shteti do të hartojë politika nxitëse dhe krijimin e kapaciteteve të mjaftueshme transmetuese.

Gjithashtu, gjatë vitit 2011, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë në shqyrtim për vlerësim, në raport me legjislacionin vendas të konkurrencës, edhe një sërë aktesh të tjera ligjore dhe nënligjore, sikurse 2 Rregullore, Metodologjia e ERRU, amendime të Ligjit “Për komunikimet elektronike në RSH”, etj. Meqenëse, përmbajtja e tyre ka rezultuar pa pasoja mbi konkurrencën dhe vlerësimet janë dhënë miratuese dhe pa vërejtje, nuk janë detajuar në këtë raport.

III.1.2. Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe udhëzues mbi zbatimin e ligjit të konkurrencës

III.1.2.1 Bashkëpunimi ndërinstitucional

Autoriteti i Konkurrencës i jep një rëndësi të vecantë bashkëpunimit, respektimit të parimit të reciprocitetit dhe të shkëmbimit të informacionit me Institucionet Qëndrore, Vendore dhe sidomos me Entet Rregullatore.

Bashkëpunimi me Entet Rregullatore dhe institucionet që mbikqyrin tregjet të caktuara në Shqipëri, zënë një vend të konsiderueshëm në aktivitetin e institucionit tonë. Bashkëpunim të ngushtë AK ka patur me Bankën e Shqipërisë, me Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare, me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, me Entin Rregullator të Energjisë, me Entin Rregullator të Ujit, etj. Anëtarë të stafit të Autoritetit të Konkurrencës janë konsultuar me anëtarë të stafeve të këtyre institucioneve në kuadër të procedurave të ndryshme të ndërmarra nga institucioni jonë, por edhe në kuadër të trajnimeve të përbashkëta bilaterale, ose shumëpalëshe të cilat në fokus kanë patur marrëdhëniet e Autoritetit të Konkurrencës dhe rregullatorëve apo ndërhyrjet e mundshme të Autoritetit të Konkurrencës në këto tregje apo sektorë me synim mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive.

Bashkëpunim të ngushtë kemi patur edhe me Agjencinë e Prokurimeve Publike, fushë në të cilën janë kryer hetime dhe vazhdojnë të kryhen hetime nga ana e Autoritetit të Konkurrencës dhe që janë bërë disa publikime të rëndësishme,

të cilat synojnë parandalimin dhe zbulimin e marrëveshjeve të fshehta në prokurime publike.

Në kuadër të bashkëpunimit me Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisionin e Integritimit Europian, Autoriteti i Konkurrencës i është përgjigjur kërkesave dhe ka depozituar informacionin e nevojshëm që është kërkuar nga ky Komision në kuadër të respektimit të detyrimeve të institucionit tonë në përmbushje të detyrimeve që parashikon MSA.

Në kuadër të nënshkrimit të Memorandumevetë Mirëkuptimit, janë nënshkruar disa prej tyre dhe janë në proces diskutimi disa të tjera. Përmendim, nënshkrimin e një memorandum mirëkuptimi (MoU) me Fondacionin "Për Liri Ekonomike". Nëpërmjet këtij MoU synohet të forcohet bashkëpunimi ndërmjet këtyre dy organeve si dhe nëpërmjet faqes zyrtare të fondacionit të publikohen të gjitha projekt aktet nënligjore që synon të adoptojë Autoriteti i Konkurrencës, për të cilat do të merret mendimi i palëve të treta si dhe të përdoret kjo faqe nga vetë Autoriteti i Konkurrencës për marrjen e dëgjimit të të gjitha projekt akteve normative të institucioneve qendrore dhe vendore për t'u vlerësuar nga institucioni ynë.

Gjithashtu, në fillim të këtij viti, Autoriteti i Konkurrencës ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me Drejtorinë e përgjithëshme të Markave dhe Patentave si dhe është në fazë nënshkrimi MoU me Autoritetin e Aviacionit Civil, me anë të të cilit synohet rritja dhe forcimi i bashkëpunimit me synim mbrojtjen e konkurrencës në sektorin e aviacionit civil dhe evidentimit të mundshëm të rasteve të praktikave anti konkurrese në këtë sektor nëpërmjet shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit dypalësh.

III.1.2.2 Udhëzuesit për zbatimin e ligjit

Përmirësimi i vazhdueshëm i instrumentave për rritjen dhe forcimin e advokacisë së konkurrencës është konsideruar si një nga sfidat e përhershme të Autoritetit të Konkurrencës. Në këtë proces dinamik pritet që numëri i akteve normative që do të adresohen Komisionit të konkurrencës për mendim pritet të rritet edhe me shumë me miratimin e Udhëzuesit "Mbi analizën e konkurrencës në procedurat për dhënien e koncesioneve", krahas Udhëzuesit "Mbi vlerësimin e pasojave të legjislacionit mbi konkurrencën" të miratuar në vitin 2008.

Gjithashtu, sikurse është raportuar gjatë vitit 2010, Autoriteti i Konkurrencës ka miratuar ***"Udhëzuesin mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike"***, i cili është realizuar si botim të financuar nga projekti i asistencës teknike, IPA-2008.

Ky udhëzues mundëson forcimin e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës në rastin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike dhe i shërben jo vetëm stafit të autoritetit në punën e tij, por edhe zyrtarëve të ndryshëm që merren me prokurimet, e publikut të gjerë të interesuar për këtë proces.

Por në radhë të parë, ky udhëzues i drejtohet bizneseve që marrin pjesë në procedurat e prokurimeve që të ndërjegjësohen se marrëveshjet në oferta janë një shkelje e rëndës e Ligjit "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe cenon interesin publik për të përfutur nga vlera më e mirë për paratë e shpenzuara.

Udhëzimi mbi analizën e konkurrencës në procedurat për dhënien e koncesioneve.

Ky udhëzues ka për qëllim analizimin e koncesioneve parë nga këndvështrimi i konkurrencës. Kjo lloj analize mund të realizohet si për koncesionet ekzistuese (*ex post*) me qëllim për të propozuar përmirësime për koncesionet e ardhshme ashtu edhe përpara miratimit formal nga autoritetet kompetente publike të një koncesioni (*ex ante*). Një koncesion është mbartës i një të drejte speciale dhe/ose ekskluzive për ushtrimin e veprimtarisë, të cilat në zbatim të Ligjit 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), janë objekt vlerësimi nga Autoriteti i Konkurrencës.

Hartimi i koncesioneve dhe procedurave të dhënies së tyre janë në përgjithësi komplekse dhe ka shumë të ngjarë të çojnë në shtrembërime të konkurrencës në treg. Për këtë arsye, është e rëndësishme që organet (institucionet) përgjegjëse ti drejtohen Autoritetit të Konkurrencës në zbatimin të kërkesave në nenet 69 dhe 70 të Ligjit Nr 9121, dt 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit mbi aspektet e mundshme anti-konkurrese, kjo listë do të jetë udhërrëfytes për pjesën tjetër të administratës në kërkimin e këshillave të Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës dhe për mënyrën e eliminimit ose të paktën të reduktimit të ndikimeve të efekteve të anti-konkurrencës të koncesioneve të propozuara. Si pasojë, pavarësisht nga përmirësimi i “klimes së biznesit” dhe parandalimit/reduktimit të shtrembërimeve të tregut, procedurat e sipërpërmendura do të përfaqësojnë gjithashtu, në rastet kur zbatohen, një instrument të plotfuqishëm si për advokacinë e konkurrencës dhe rregullat e ndihmës shtetërore, ashtu edhe për forcimin e nivelit të bashkëpunimit administrativ ndërmjet institucioneve. Prandaj, lind e nevojshme të kuptohet drejt jo vetëm nevoja për të marrë mendimin e Ak-së, për vlerësimin e koncesioneve, por domosdoshmëria e realizimit të një detyrimi ligjor.

III. 1.3. Aktet nënligjore

Kuadri ligjor në fushën e konkurrencës përbëhet nga Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) dhe aktet dytësore të nevojshme për zbatimin e tij. Më synim përfarimin e legjislacionit në fushën e konkurrencës, Autoriteti i Konkurrencës ka hartuar dhe miratuar rregullore të cilat ndihmojnë jo vetëm punonjësit e Autoritetit në vlerësimin dhe interpretimin e dispozitave ligjore parësore, por edhe të tretët në vlerësimin e situatës së konkurrencës në treg. Gjatë vitit 2011, Komisioni i Konkurrencës ka miratuar tre rregullore për përjashtimet në bllok, rregulloren “Për procedurat hetimore që zbaton Autoriteti i Konkurrencës” si dhe Rregulloren “Për marrëveshjet më rëndësi të vogël”.

Detyrimi ligjor, i cili buron nga neni 6 i Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), sipas të cilit duhet të miratohen rregulloret për përjashtimet në bllok është zbatuar nga Autoriteti i Konkurrencës dhe po vazhdon të zbatohet duke plotësuar kuadrin ligjor dytësor me aktet e nevojshme dytësore.

Tre rregullore të përjashtimit në bllok: “**Per kategoritë e marrëveshjeve të transfertave teknologjike**”; “**Per përjashtimin e kategorive të marrëveshjeve të kerkimit dhe zhvillimit**”; “**Për përjashtimin e kategorive të marrëveshjeve të specializimit**” janë plotësisht të përafuara me legjislacionin Europian ((i). Rregullorja e Komisionit (EC) Nr 772/2004 e datës 27 Prill 2004 “Mbi zbatimin e

nenit 81/3 të Traktatit për kategoritë e marrëveshjeve të trasfertave teknologjike” ;(ii). Rregullorja e Komisionit Nr 1217/2010 e datës 14 Dhjetor 2010 “Mbi zbatimin e nenit 101(3) të Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit Europian për kategoritë e marrëveshjeve të Kërkimit dhe Zhvillimit; (iii). Rregullorja e Komisionit Nr 1218/2010 e datës 14 Dhjetor 2010 “Mbi zbatimin e nenit 101(3) të Traktatit për kategoritë e marrëveshjeve të specializimit”) dhe parashikojnë përjashtime për ato kategori marrëveshjesh të cilat bazuar në pjesën e tregut dhe në eficientat ekonomike nuk ndalohen sipas nenit 4 të Ligjit. Janë vetë ndërmarjet, të cilat bëjnë vlerësimin e marrëveshjeve që ato lidhin me njëra tjetrën dhe vendosin. Sidoqoftë, në cdo rast, mund të kërkohet miratimi me një vendim të Komisionit të Konkurrencës, i cili pasi bën vlerësimin e një marrëveshjeje të ndaluar vendos nëse kjo marrëveshje është objekt përjashtimi apo jo.

Rregullorja “**Për procedurat hetimore që zbaton Autoriteti i Konkurrencës**” është hartuar me asistencën e programit të ekspertizës teknike, në përputhje të plotë me rregulloren e Bashkimit Europian, Rregullorja e Këshillit (EC) Nr 1/2003 e datës 16 Dhjetor 2002 “Mbi zbatimin e rregullave të konkurrencës sipas neneve 81 dhe 82 të Traktatit” dhe parashikon rregullat që duhen të zbatohen gjatë një procedure hetimore kur shqyrtohen marrëveshjet e ndaluara apo një abuzim potencial me pozitën dominuese. Rregullorja është një risi pasi paraqet dispozita lidhur me të drejtën për t’u ankuar, më të drejtën për t’u njohur me dosjen hetimore, me organizimin e seancave dëgjimore, më të drejtat e palëve të treta për t’u përfshirë në proces etj.

Në lidhje me rregulloren “**Për marrëveshjet më rëndësi të vogël**”, e cila ka përafuar njoftimin e Komisionit Europian “Mbi marrëveshjet më rëndësi të vogël, të cilat nuk e kufizojnë konkurrencën sipas nenit 81/1 të traktatit themelues të Komunitetit Europian”(de minimis), miratimi i kësaj rregulloreje sjell një përafrim të plotë dhe parashikon ato kategori marrëveshjesh të cilat bazuar në pjesën e tregut nuk ndalohen sipas nenit 4 të Ligjit. Por, në cdo rast, rregullorja parashikon edhe dispozita, sipas të cilave pavarësisht nga pjesa e tregut apo karakteristika të tjera të marrëveshjeve, ato konsiderohen si marrëveshje që kufizojnë konkurrencën pasi sjellin kufizime, deformime apo shtrembërime të konkurrencës në treg, dhe si të tilla konsiderohen marrëveshje të ndaluara.

III.2. Kultura e konkurrencës – marrëdhëniet me publikun dhe mediat

Ndërgjegjësimi i publikut dhe rritja e kulturës së konkurrencës, është një nga prioritetet e vazhdueshme të punës së Autoritetit të Konkurrencës. Gjithashtu, dhënia e informacionit për veprimtarinë e Autoritetit është një detyrim në kuadër të parimit të transparencës së veprimtarisë së institucionit dhe funksionarëve të tij. Për këto arsye Autoriteti i Konkurrencës, i ka kushtuar një rëndësi të veçantë informimit publik si në mënyrë të drejtpërdrejtë me anë të faqes së internetit dhe publikimeve të ndryshme, ashtu edhe me anë të mediave audio - vizive dhe të shkruara.

III.2.1. Marrëdhënia me publikun

Website: Faqja zyrtare e internetit të Autoritetit të Konkurrencës ofron një informacion të detajuar në lidhje me akvitetin e institucionit tonë dhe shërben si një mjet për t'u lidhur me publikun e gjerë, biznesin dhe median. Faqja e internetit përditësohet mbi baza ditore në lidhje me praktikën dhe informacionet për AK-në, Ligjin në fushën e konkurrencës, kuadrin ligjor dytësor, aktivitetin e Komisionit të Konkurrencës, publikimet, etj. Çdo vendim i Komisionit të Konkurrencës publikohet në faqen zyrtare menjëherë sapo ai të jetë marrë. Në këtë faqe çdo i interesuar mund të gjejë informacion në lidhje me përqëndrimet që priten të ndodhin duke u dhënë palëve të interesuara mundësinë që të shprehen dhe të sjellin opinionet e tyre në lidhje me këto përqëndrime. Faqja zyrtare e internetit të Autoritetit të Konkurrencës është e disponueshme në gjuhën shqipe dhe atë angleze.

Publikime: Një rëndësi të vecantë i është kushtuar publikimeve të materialeve të ndryshme të konkurrencës, të cilat janë një ndihmesë për biznesin, për institucionet qendrore dhe rregullatorët etj. Ndër publikimet e AK-së përmendim:

1. Konkurrenca në prokurimet publike: “Si të parandalohen dhe zbulohen marrëveshjet e ndaluara në prokurimet publike” (broshure);
2. Konkurrenca në prokurimet publike : Red flag leaflet;
3. Përmbledhje e kuadrit ligjor parësor dhe dytësor në fushën e konkurrencës
4. E drejta e konkurrencës në Shqipëri (broshure);
5. Vlerësimi i ndikimit rregullator dhe konkurrenca në tregjet e rregulluara (broshure);
6. Konkensionet, konkurrenca dhe rregullat e ndihmës shtetërore, një listë analitike për identifikimin e disa çështjeve kritike (broshure);
7. Raporti vjetor 2010 dhe synimet kryesore për vitin 2011.

III.2.2. Marrëdhënia me median

Mediat e shkruara dhe audio-vizive, kanë treguar një vëmendje të veçantë për pasqyrimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës. Komunikimi me mediat është realizuar nëpërmjet njoftimeve për shtyp, intervistave, konferencave të shtypit, pjesëmarrjes në programe të ndryshme televizive etj. Ky komunikim i drejtpërdrejtë me publikun ka ndikuar në rritjen e kulturës së konkurrencës dhe ndërgjegjësimin e publikut si në drejtim të publikut të specializuar (akademikë, ekonomistë, juristë, biznesmenë, zyrtarë publikë etj.) ashtu edhe ndaj publikut të gjerë, i cili është prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga vendimet e Autoritetit të Konkurrencës.

Për vendimet e Autoritetit të Konkurrencës dhe aktivitetet e ndryshme të institucionit janë hartuar njoftime për mediat nga Kabineti i Autoritetit dhe i janë shpërndarë organeve të ndryshme të medias vendase dhe përfaqësuesve të mediave të huaja në Shqipëri. Gjithashtu, Autoriteti mban marrëdhënie të vazhdueshme edhe me median e specializuar ndërkombëtare në fushën e inteligjencës së tregut si MLEX, ILO etj.

IV. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Rritja e rolit të Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës në rrjetet rajonale dhe ndërkombëtar të konkurrencës ka qënë një nga objektivat për të cilën është punuar gjatë vitit 2011. Për më tepër institucioni i konkurrencës është pjesë e rrjetit ndër-institucional të integritit, i cili luan rol koordinues për një kapitull të veçantë, si dhe kontribuon në plotësimin e detyrimeve dhe raportimin edhe të kapitujve të tjerë.

IV.1 Bashkëpunimi me Komisionin Europian

Sipas Raportit të Komisionit Europian për Kapitullin 8 "Politika e Konkurrencës", AK ka bërë disa përparime në fushën e konkurrencës dhe pasqyron një progres të konsiderueshëm për sa i përket mbrojtjes së konkurrencës dhe fushës së konkurrencës në përgjithësi.

Kapitulli 8: Politika e konkurrencës² Janë bërë disa përparime në fushën anti-kartel, përfshi bashkimet. Qeveria miratoi akte normative për Procedurat e Hetimit, për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës (AK), për Marrëveshjet me Rëndësi të Vogël ("de minimis") dhe akte normative për përjashtimin në grup për marrëveshjet e transferimit të teknologjive, marrëveshjet për kërkimin dhe zhvillimin dhe marrëveshjet e specializimit. Këto akte janë të harmonizuara me acquis në të gjitha aspektet themelore. Parlamenti miratoi një rezolutë që detyron të gjitha organet ekzekutive të konsultohen me Autoritetin e Konkurrencës kurdo që hartohet legjislacion parësor ose dytësor. Nuk janë bërë përparime për sa i përket kapaciteteve administrative të AK-së. Vazhdon të ketë një staf prej 35 personash dhe kërkohen përpjekje për ta forcuar në raport me detyrat që i ngarkohen AK-së. AK miratoi dy vendime për marrëveshjet anti-kartel dhe dy vendime për abuzimin me pozitën dominuese. AK vuri gjoba me vlerë rreth 245 500 euro për shkelje të rregullave të konkurrencës. Shtatë bashkime të propozuara i janë njoftuar AK-së që i ka autorizuar pa kushte. AK përfundoi hetimin në sektorët bankarë, farmaceutikë dhe energjetikë dhe i përcolli rekomandimet përkatëse qeverisë. Gjithashtu, AK filloi një hetim të thelluar në tregjet e bukës dhe në tregjet e ngarkim/shkarkimit dhe depozitave të gazit të lëngshëm natyror në objektet portuale. Përfundim: Shqipëria ka bërë përparim të moderuar në fushën e konkurrencës. Megjithatë, autoriteteve përgjegjëse u mungojnë kapacitetet administrative dhe nevojiten masa për të garantuar pavarësinë operationale të Komisionit të Ndhmës Shtetërore. Përgatitjet janë përgjithësisht në rrugën e duhur.

Autoriteti i Konkurrencës, në vijim të Raportit të stabilizim-asociimit për vitin 2011, analizoi rekomandimet e bëra në këtë raport në lidhje me Kapitullin 8 "Politika e Konkurrencës", duke nxjerrë detyrat dhe përgjegjësitë konkrete që

²Përkthim i Ministrisë së Integritit

parashikonte ky raport dhe duke i kthyer ato në një plan masash administrative për zbatim dhe plotësimin e tyre. Për zbatimin e këtyre rekomandimeve janë ndarë përgjegjësitë konkrete sipas sektoreve dhe drejtorive të Autoritetit, ku përcaktohen objektivat e përcjella nga ky raport në drejtim të nismave ligjore dhe forcimit të kapaciteteve institucionale.

Autoriteti i Konkurrencës, si institucioni koordinues për Kapitullin 8 “Politika e Konkurrencës” i ka kushtuar rëndësinë maksimale procesit të raportimit të progresit të ndodhur jo vetëm në fushën e konkurrencës, por edhe në fushat për të cilat raporton institucioni. Autoriteti ka bashkëpunuar ngushtësisht me anëtarët-pjesëtarë të grupit ndërinstitucional të punës për Kapitullin 8 në mënyrë që të pasqyrohet sa me realisht dhe qartësisht situata aktuale përsa i përket kuadrit ligjor, aktiviteteve zbatuese, procesit të vlersimit të konkurrencës dhe ndërhyrjes në tregjet e rregulluara, dhënies së mendimeve dhe opinioneve për të drejtat e vecanta dhe eksklusivitetet etj.

Në takimet e zhvilluara me Komisionin Europian është relatuar në lidhje me situatën aktuale në Shqipëri dhe progresin e arritur në fushat përgjegjëse. Nga ana e Autoritetit të Konkurrencës është siguruar pjesëmarrja në Nënkomitetin për Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit e mbajtur në Prill 2011. Në këtë takim Autoriteti i Konkurrencës prezantoi rezultatet e arritura në procesin e përfarimit dhe zbatimit të legjislacionit në fushën e konkurrencës dhe ndihmës shtetërore.

IV.1.1 Detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizimi-Asociimit për Autoritetin e Konkurrencës

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit është instrumenti Europian, i cili do të mundësojë integrimin gradual të Shqipërisë në Bashkimin Europian, duke krijuar kuadrin e duhur për forcimin e shtetit ligjor. Kjo marrëveshje parashikon adoptimin e *acquis communautaire* (tërësisë së rregullave dhe normave të BE-së) në sistemin juridik të brendshëm të Shqipërisë. Qëllimi i përafrimit të legjislacionit është krijimi i një kuadri ligjor dhe institucional që do të lejojë tregun shqiptar të integrohet në tregun e brendshëm europian, me synimin parësor të përfitimit dhe mbrojtjes së interesave të shtetasve shqiptarë.

Detyrimet që rrjedhin nga MSA për Autoritetin e Konkurrencës lidhen me përmbushjen e kriterit ekonomik të Kopenhagenit për anëtarësim në BE, dhe ka të bëjë me aftësinë për të përballuar detyrimet e anëtarësisë në BE, dhe konkretisht janë nenet 71 dhe 72 të MSA që parashikojnë detyrimet dhe përgjegjësitë e Autoritetit të Konkurrencës në kuadër të mbrojtjes së konkurrencës nga veprimet dhe praktikant antikonkurrese që mund të ndikojnë në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë (NENI 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”) si dhe detyrat që parashtrohen para AK-së në rastet e të drejtave eksklusive apo të vecanta, të cilat me ndryshimet e fudit që pësoi Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” në tetor të 2010, zënë një vend të veçantë dhe ka një dispozitë konkrete pikërisht për zbatimin dhe respektimin e këtyre rregullave (NENI 72 “Sipërmarrjet publike “)

IV.1.2 Raportimi periodik

Autoriteti ka mbajtur kontakte të rregullta me **Ministrinë e Integritimit Europian** dhe ka përcjellë raporte, të cilat pasqyrojnë progresin e arritur në drejtim

të realizimit të masave ligjore dhe aktiviteteve zbatuese, në përputhje me afatet e parashikuara në Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së,(PKZMSA) si dhe një përshkrim të shkallës së përputhshmërisë me **acquis** të akteve juridike të miratuara në fushën e konkurrencës. AK ka raportuar sipas kërkesave të vetë Ministrisë së Integritit duke mbuluar fushën e konkurrencës dhe fushat për të cilat AK është koordinatore e Kapitullit 8 “Politika e Konkurrencës”. Kanë vazhduar raportimet periodike çdo 2 muaj pranë (me ndërmjetësimin e Ministrisë së Integritit) Komunitetit European, në lidhje me zhvillimet legjislative, masat dhe projektet e kapacitetin institucionale në lidhje me periudhën raportuese; raportim vjetor në lidhje me të gjitha zhvillimet në fushën e konkurrencës, bashkëpunimit dhe procedurat hetimore të ndërmarra, vendimet e Komisionit të Konkurrencës, proceset e ndryshme dhe monitorimet e tregut, forcimi i kapaciteteve institucionale, rishikim dhe përditësim me legjislacionin më të fundit komunitar në këtë fushë etj. AK si një nga institucionet përgjegjëse për një nga kapitujt kryesore për të cilat Shqipëria do të negociojë , i ka kushtuar vëmendjen maksimale procesit të integritit European, duke u përgjigjur me saktësi, rigorozitet, në respektim të afateve dhe sa më realisht për situatën në të cilën ndodhet fusha e konkurrencës në periudhat përkatëse. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit parashikon adoptimin e *acquis communautaire* (tërësisë së rregullave dhe normave të BE-së) në sistemin juridik të brendshëm të Shqipërisë. Qëllimi i përafrimit të legjislacionit është krijimi i një kuadri ligjor dhe institucional që do të lejojë tregun shqiptar të integrohet në tregun e brendshëm european me synimin parësor të përfitimit dhe mbrojtjes së interesave të shtetasve shqiptarë.

IV.1.3 Projektet e mbështetjes IPA 2008

Projekti IPA 2008, “Mbështetje për Autoritetin e Konkurrencës dhe Departamentin e Ndihmës Shtetërore”, i cili ofron asistencë për Autoritetin e Konkurrencës dhe Departamentin e Ndihmës Shtetërore pranë Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikë, është i ndarë në dy programe, atë të Ekspertëzës/Asistencës Teknike dhe Programi i Binjakëzimit.

Projekti i Asistencës Teknike, i cili ka për objektiv të kontribuojë në sigurimin e një mjedisi konkurrues në Shqipëri, nëpërmjet paraqitjes së project ndryshimeve në kuadrin ligjor parësor dhe atë dytësor në fushën e konkurrencës me qëllim harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar të konkurrencës me atë të **acquis communautaire**; shqyrtimine legjislacionit parësor dhe dytësor ekzistues me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së tij me atë të legjislacionit european, përkthime të ndryshme të *Acquis*, si dhe publikime të ndryshme të materialeve të konkurrencës, organizimin e konferencave dhe seminareve për grupe të caktuara interesi etj, filloi zbatimin në muajin Prill 2010 dhe përfundoi në Dhjetor 2011.

Të dy programet e projektit në total përfshijnë shumën prej 1.5 milionë euro dhe synojnë në promovimin e konkurrencës, më lehtësimin e zbatimit të politikës dhe rregullave të konkurrencës, në përfarimin e legjislacionit dhe shkëmbimit të ekpëriencës dhe rritjen e profesionalizmit të stafit , në rritjen e kulturës dhe ndërgjegjësimit të publikut dhe të te tretëve për politikën dhe rregullat e konkurrencës, në rritjen e kulturës dhe advokacisë së konkurrencës, në ofrimin e asistencës për publikime dhe disa përkthime, në organizimin e eventeve publike për grupe të caktuara interesi etj.

Projekti i "binjakëzimit", ofron asistencë në rritjen e profesionalizmit dhe të eksperiencës së stafit të AK-së nëpërmjet trajnimeve dhe ofrimit të ekspertizës së ekspertëve italianë dhe hungarezë të autoriteteve respektive të konkurrencës, në shqyrtimin e rasteve konkrete dhe atyre hipotetike për marrëveshjet e ndaluara, abuzimin me pozitën dominuese dhe kontrollin e përqëndrimeve, në forcimin e marrëdhënieve me rregullatorët dhe konkretisht në sektorin financiar, bankar, telekomunikacioneve, energjisë, ujë etj, në organizimin e eventeve të përbashkëta me rregullatorët dhe me vendet e rajonit, bashkëpunimi me gjykatat etj.

Synim i projektit është forcimi i kapaciteteve institucionale të AK-së, si një nga rekomandimet kryesore të Komisionit European në progres raportet e viteve të fundit si dhe i sektorëve të veçantë rregullatorë dhe sistemit gjyqësor përsa i përket zbatimit të rregullave të konkurrencës. Target grupi kryesor që synon projekti janë edhe bizneset, studentët e drejtësisë dhe të shkollës së magistraturës, gjyqtarët, përfaqësues të institucioneve publike qëndrore dhe atyre lokale, si dhe vetë publiku i gjerë.

IV.2. Bashkëpunimi me OECD (RCC Budapest)

Trajnimi i punonjësve, ka qenë dhe mbetet një ndër objektivat prioritar të AK-së. Në këtë drejtim, Autoriteti i Konkurrencës ka parashikuar dhe zbatuar metoda dhe mënyra të ndryshme trajnimi, duke synuar zhvillimin e burimeve njerëzore, rritjen e profesionalizmit nëpërmjet plotësimit të objektivave të matshëm lidhur me kualifikimin profesional të punonjësve, duke synuar rritjen e performancës së institucionit.

Çdo fillim viti, Autoriteti harton strategjinë e trajnimit për vitin në vazhdim, përkatësisht, trajnimin e punonjësve brenda dhe jashtë vendit. Gjatë këtij viti, trajnimi i punonjësve është realizuar nëpërmjet programimit dhe shfrytëzimit të të gjitha formave të mundshme të trajnimit.

Një forum i rëndësishëm në të cilin diskutohen çështjet e politikës së konkurrencës dhe rastet konkrete anti konkurrese është edhe Organizata për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) me qendër në Budapest RCC(Qendra Rajonale për Bashkëpunim) në të cilën Shqipëria merr pjesë aktivisht duke u përfaqësuar nëpërmjet stafit të saj dhe rasteve konkrete të shqyrtuara.

IV.3. Bashkëpunimi me Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës (ICN) dhe Autoritet e Rajonit.

Autoriteti i Konkurrencës, si një anëtar i ICN-së, ka marrë pjesë në grupet e punës të organizuara nga ky rrjet. Vetë rrjeti i ICN-së merret me çështjet në fushën e konkurrencës, me legjisllacionin dhe politikën e konkurrencës duke synuar në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve të konkurrencës duke arritur një konvergencë ndërmjet legjisllacioneve dhe praktikave zbatuese të ligjeve.

Në kuadër të homologëve tanë në Rajon janë intesifikuar bashkëpunimet ngushtësisht me Komisionin e Konkurrencës së Republikës së Kosovës. Në këtë

kuadër ka pasur vizita të ndërsjellta në nivel titullarësh dhe ekspertësh, për të shkëmbyer përvojat me njëri-tjetrin dhe zgjidhjen e problematikës së hasur.

V. Prioritetet e punës për vitin 2012

Liria ekonomike dhe mirëfunksionimi i tregut, përbëjnë sfidat e ekonomisë shqiptare dhe forcimi i zbatimit të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” përbën një domosdoshmëri për kapërcimin e situatës aktuale ekonomike, ashtu edhe për rritjen e qëndrueshme të ekonomisë së vendit. Ky mision kërkon një institucion të konkurrencës me një profil në rritje profesionale dhe publike si dhe një ambient shumë më tepër motivues për konkurrencën e lirë dhe efektive në treg.

Pra, dy do të jenë drejtimet kryesore të veprimtarisë së institucionit të konkurrencës për vitin që ka filluar: rritja e shpejtësisë së ndërhyrjeve në treg, nëpërmjet rritjes së profesionale të punonjësve të Autoritetit; si dhe forcimi i bashkëpunimit dhe ndërveprimit ndërinstitucional me entet rregullatore dhe institucionet e tjera publike, të cilat luajnë një rol shumë të rëndësishëm në lirinë ekonomike dhe mirë funksionimin e tregut.

Në mënyrë më të detjuar synimet kryesore të punës së Autoritetit të Konkurrencës gjatë 2012 do të jenë:

V.1. Zbatimi i ligjit të konkurrencës

Ritja e efikasitetit të tregjeve për t'i vendosur mbi baza konkurruese dhe mbi të njëjtat rregulla loje të gjithë konkurrentët është një nga synimet kryesore të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2012. Shqyrtimi i ankesave dhe ndërhyrja sa më e shpejtë, si dhe monitorimi i tregjeve kryesore dhe tregjeve ku shfaqen shenja të kufizimit të konkurrencës, do të përbëjnë instrumentat bazë për rritjen e forcës zbatuese të ligjit.

Tashmë janë një sërë procedurash hetimore në vijim ndërkohë që prioritetet kryesore për vitin 2012 do të përqëndrohen në rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në tregjet me struktura monopol apo të dominuar, ose ku shfaqen forma antikonkurruese. Tregjet kryesore ku mendohet të fokusohet puna e Autoritetit, por jo vetëm, për vitin 2012 janë: tregu i prokurimeve publike për marreveshje të ndaluara; telekomunikacioni - telefonia fikse me parapagim; energjia elektrike - mbikëqyrja e ndërmarrjeve monopol në segmente të ndryshme të tregut të energjisë elektrike (prodhim, transmetim, shpërndarje); mbikëqyrja ex-post- sjellja e ndërmarrjeve në tregun e shërbimit të transportit ajror

Plotësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor sekondar me rregullore dhe udhëzues është një drejtim tjetër i punës së Autoritetit, i cili ka ndikim të drejtëpërdrejtë më forcimin e zbatimit të ligjit të konkurrencës. Aktualisht është në proces përshtatja dhe miratimi i njoftimit të konsoliduar të BE për përqëndrimet dhe autorizimi i përqendrimeve sipas rastit; udhëzues për vlerësimin e rasteve të abuzimit me pozitën dominuese në treg (kryesisht për rastet e çmimeve grabitqare, ngjeshja e çmimeve, si dhe skontot dhe rabate). Gjithashtu është parashikuar që të hartohen: rregullore mbi zbatimin e ligjit të konkurrencës në sektorin e telekomunikacioneve; mbrojtja e pronësisë industriale në sektorin farmaceutik; metodikat e llogaritjes së dëmit konsumator, abuzimi me praktika përjashtuese etj.

V.2 Advokacia dhe kultura e konkurrencës

Për të forcuar advokacinë e konkurrencës si një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm për zbatimin e Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Autoriteti i Konkurrencës duhet të rrisi rolin e vet proaktiv në bashkëpunimin ndërinstitucional.

Marrja e vlerësimit të Komisionit të Konkurrencës për të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore përbën një detyrim ligjor për të gjitha institucionet publike apo entet rregullatore, i cili jo gjithmonë zbatohet. Në këtë këndvështrim, konsolidimi i vlerësimit të akteve ligjore si pjesë përbërëse e Reformës Rregullatore përbën një instrument për të cilën Autoriteti i Konkurrencës ka investuar.

Duke rritur ndërgjegjësimin mbi aspektet e mundshme anti-konkurrese të legjislacionit të propozuar, përdorimi i “listë kontrollit” për vlerësimin e konkurrencës, do të drejtojë administratat e tjera t’i kërkojnë mendim këshillimor pranë Autoritetit të Konkurrencës për mënyrën e eliminimit apo të paktën të reduktimit të efektit anti-konkurrese të legjislacionit të propozuar. Për realizmin e këtij objekti, Autoriteti i Konkurrencës do të synojë krijimin e një “grupi pune ndërinstitucional për çështjet e konkurrencës”, me përfaqësues të ministrive përkatëse dhe institucioneve publike si dhe ka planifikuar të investojë për trajnimet e tyre, duke përdorur fondet dhe ekspertizën e projekteve të IPA -2008.

Studimi i tregjeve ku janë dhënë të drejta ekskluzive dhe të drejta të veçanta do të përbëjë një instrument tjetër , për rritja e advokatisë së ligjit dhe politikës së konkurrencës. Njëpërmjet realizimit të këtij studimi do të mundësohen identifikimi i rekomandimeve për liberalizim e mëtejshëm të këtyre sektorëve apo segmente të tregjeve. Gjithashtu, do të organizohen workshope me përfaqësues të institucioneve publike për të zbatuar udhëzuesin e vlerësimit të koncesioneve, pasi marrja e vlerësimit të Komisionit të Konkurrencës para dhënies së të drejtave ekskluzive dhe të veçanta është një detyrim ligjor që duhet zbatuar për të përmirësuar klimën e biznesit.

Për të rritur kulturën e konkurrencës jo vetëm tek komuniteti i biznesit, por edhe tek publiku u gjerë, duke përdorur eksperiencën e vendeve të tjera do të bashkëpunohet me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për të përfshirë në nivele të ndryshme të arsimit para universitar tema mbi konkurrencës ku do të përdoren skema njohëse në përputhje me karakteristikat e grup-moshave. Gjithashtu, duke përdorur projektin e binjakëzimit të financuar nga BE-ja do të organizohen workshope rajonale në Shkoder dhe Tiranë.

V.3. Hartimi i dokumentit të ri të Politikës së Konkurrencës

Dokumenti ekzistues i Politikës së Konkurrencës është miratuar nga Komisioni i Konkurrencës, me vendim nr. 43, datë 28.12.2006, në zbatim të nenit 24/a, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Ky dokument është mbështetur në tri argumente kryesore: (i) kushtet ekonomike dhe politike që bënë të nevojshëm miratimin e legjislacionit për konkurrencën dhe ngritjen e Autoritetit të Konkurrencës; (ii) mbikëqyrja e tregut në këndvështrimin e konkurrencës dhe (iii) zbatimi i standardeve të Bashkimit Europian në mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Gjatë vitit 2012, do të punohet për përditësimin e këtij dokumenti me kushtet e reja ekonomike, politike dhe sociale, instrumentat e reja dhe të përmirësuara për mbikëqyrjen e tregut dhe zhvillimet më të fundit të Acquis të Bashkimit European. Duke marrë në konsideratë ndryshimet e Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” në vitin 2010, një përditësim i politikës së konkurrencës është një domosdoshmëri për të reflektuar këto ndryshime ligjore dhe përmirësimet që kanë sjellë në punën e Autoritetit të Konkurrencës.

Për më tepër, ky dokument do të jetë produkt i një bashkëpunimi shumë të gjërë me të gjithë : Kuvendin e Shqipërisë, Këshillin e Ministarve, entet rregullatore, institucionet qendrore dhe lokale, komunitetin e biznesit dhe të mbrojtjes konsumatore, si dhe median, për të mundësuar jo vetëm gjithëpërfshirjen, por ndërgjegjësimin për përgjegjësitë respektive.

V.4. Rritja e kapaciteteve administrative

Forcimi i kapaciteteve administrative nëpërmjet trajnimeve të planifikuara sipas kërkesave të drejtorive dhe rekomandimeve të Komisionit European në Progres Raportin e fundit do të realizohet nëpërmjet pjesmarrjes në seminarët trajnuese të organizuar nga projekti i BE-së në mbështetje të Autoritetit të Konkurrencës (Binjakëzimit) RCC(OECD), ICN etj.

Stafi i Autoritetit të Konkurrencës do të marrë pjesë në workshope apo konferenca të organizuara nga entet publike, me qëllim mbrojtjen e konkurrencës së lire dhe efektive në treg nëpërmjet parandalimit dhe zbulimit të praktikave anti konkurrese; si marreveshjet e ndaluar, abuzimi me poziten dominuese , kontrolli i perqendrimeve, etj.

Gjatë vitit 2012 pritet rritja e kapaciteteve të Autoritetit me shtimin e punonjësve sipas Ligjit të Buxhetit të vitit 2012, duke plotësuar në këtë mënyrë strukturën organizative sipas kërkesave në rritje për staf në sektorin e përqendrimeve dhe atë të analizës së tregut duke përbushur në këtë mënyrë dhe sugjerimet e Raport-progresit të Komisionit European.

Shtojcë 1-Të dhëna statistikore mbi vendimet e Komisionit të Konkurrencës sipas viteve

Viti	Vendimet ne total	Përqendrime	Abuzimin me Pozitën Dominuese	Marrëveshje te ndaluara	Përjashtime nga Marrëveshjet	Rregullore dhe Udhëzues	Rekomandime ndaj Institucioneve Publike	Vendime për vendosje gjobe	Vendime te tjera
2004	13	2				6	1	-	4
2005	17	-				2	3	1	11
2006	14	4				-	1	1	8
2007	25	9	1	3		4	2	5	2
2008	29	11	1		1	4	5	-	7
2009	36	8	1	2	1	2	10	2	10
2010	34	6	3	2	-	7	5	2	9
2011	43	10	2	2	-	6	5	1	17
Totali	211	50	8	9	2	31	31	12	68

Shtojcë 2: Ekzekutimi i gjobave të vendosura nga Komisioni i Konkurrencës deri më 31 Dhjetor 2011


<i>Gjobat e vendosura nga AK</i>	<i>Shuma në lekë</i>	<i>Përqindja ndaj totali³</i>
Gjopa të vendosura në total	1.093.503.130	100
Gjopa të mbledhura nga përbarimi	258.966.139	23.7%
Gjopa në proces mbledhjeje nga përbarimi ⁴	214.152.000	19.6%
Gjopa për të cilat nuk është marrë ende një vendim gjyqësor ⁵	620.384.991	56.7%

³ Shifrat në përqindje janë të rrumbullakosura

⁴ Ekzekutimi i Gjobës 211552000 lekë ndaj AMC, është pezulluar nga Gjykata e Lartë deri në përfundim të procesit.

⁵ Janë akoma në shqyrtim gjyqësor ose nuk ka dalë ende vendimi për titull ekzekutiv

Shtojcë 3: Struktura e Autoritetit të Konkurrencës



Shtojcë4: Përqëndrimet e njoftuara dhe të autorizuar

Nr	Rasti i Përqendrimit	Tregu Përkates	Nr. i Vendimit	Data e Autorizimit	Procedura
1	Auto Master Sha – Tirana Auto Shpk	Shitje Automjete të Reja	169	07.01.2011	Faza e parë/ Formulari i thjeshtuar i njoftimit
2	Auto Master Sha – Hyundai Albania Shpk	Shitje Automjete të Reja	170	07.01.2011	Faza e parë/ Formulari i thjeshtuar i njoftimit
3	Sigal Life Uniqa Group Austria Sha- Capital Sha	Tregu i pensioneve private vullnetare	183	29.03.2011	Faza e parë/ Formulari i thjeshtuar i njoftimit
4	Sicred Sha – Sigma I.P.P Sh.a	Tregu i pensioneve private vullnetare	186	12.04.2011	Faza e parë/ Formulari i thjeshtuar i njoftimit
5	Delhaize “The Lion” Nederland B.V - Delta Maxi Serbia d.o.o	Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore dhe mallrave të konsumit në dyqane të paspecializuara	188	26.05.2011	Faza e parë/ Formulari i thjeshtuar i njoftimit
6	Volkswagen Aktiengesellschaft - MAN SE	Tregu i prodhimit dhe shitjes së kamionëve	195	22.07.2011	Faza e parë/ Formulari i thjeshtuar i njoftimit
7	Vienna Insurance Group AG - Intersig Sh.a	Tregu i sigurimeve (Sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit, sigurimet motorrike, sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë, etj)	199	15.09.2011	Faza e dytë/ Formulari i plotë i njoftimit
8	Japan Tobacco Group, (JT) - Haggar Cigarette & Tobacco Factory Ltd., (HTCF)	Tregtimi i cigareve MMC ⁶ të prodhuara nëpërmjet makinerive dhe produkteve të tjera të duhanit	200	15.09.2011	Faza e parë/ Formulari i thjeshtuar i njoftimit
9	Alpha Bank S.A - EFG Eurobank Ergasias S.A	Tregu i shërbimeve bankare për individë (retail banking) dhe korporata(corporate banking)	206	18.11.2011	Faza e parë/ Formulari i thjeshtuar i njoftimit
10	Xerox Spa - XL World Europe Srl	Shërbimi i telemarketingut	208	05.12.2011	Faza e parë/ Formulari i thjeshtuar i njoftimit

⁶ MMC përfshin të gjitha cigarete e prodhuara nëpërmjet makinerive.

Shtojcë 5. Lista e Vendimeve të Komisionit për ekzekutimin e gjobave

Nr.	Vendimi i Komisionit	Lëshimi i Urdhërit të Ekzekutimit nga Gjykata	Dërguar në përbarim	Statusi i ekzekutimit
1	Nr. 38 datë 16. 05.2006 "Vendosje gjobe ndaj Çalik Seker Konsorsyum"	Vendimi Nr. 3354 Akti datë 12.11.2010	Po	Ekzekutuar
2	Nr. 59 datë 09.11.2007 "Vendosje gjobe ndaj AMC SHA dhe Vodafone SHA"	Vendimi Nr. 3359 Akti datë 09.11.2010 (Vetem per pjesen qe i perket AMC)	Po	Pezulluar me Vendim të Gjykatës se Larte, date 18.02.2011
3	Nr. 63 datë 03.11.2007 "Vendosje gjobe ndaj Procredit Holding AG"	Vendimi Nr. 3358 Akti datë 22.11.2010	Po	Ekzekutuar
4	Nr. 66 datë 18.12.2007 "Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve që operojnë në tregun e betonit"	Vendimi Nr. 3357 Akti datë 22.12.2010	Po	Ekzekutuar
5	Nr. 67 datë 24.12.2007 "Marrje sanksioni individual ndaj z. Kajo Hallka"	Vendimi Nr. 3356 Akti datë 10.12.2010	Po	Vazhdon (Është kërkuar t'i kalojë Zyrës së Përbarimit Fier, për shkak se z. Hallka banon në Fier)
6	Nr. 123 datë 08. 09. 2009 "Vendosje gjobe ndaj "Albanian Airlines MAK" SHPK.	Vendimi Nr. 3355 Akti datë 12.11.2010	Po	Vazhdon, ekzekutimi detyrueshëm
7	Nr.59 datë 09.11.2001 "Vendosje Gjobe ndaj AMC SHA dhe Vodafone SHA" (vetem per Vodafone)	Vendimi Nr. 4281 Akti datë 22.07.2011	Po	Ekzekutuar

Shtojcë 6. Pasqyra e rishikimit gjyqësor të vendimeve të Komisionit të Konkurrencës

Çështja	Objekti	Gjykata	Perfundimi
1. La Petrolifera Italo Albanese vs. AK	Kundërshtim VKK Nr. 140 datë 10.03.2010	Rrethi Gjyqësor Tirane	Pushuar /Fituar
2. ARMO SHA vs. AK	Kundershtim VKK Nr. 150 datë 20.07.2010	Rrethi Gjyqësor Tirane	Pranuar Padia /Humbur
3. NOTI SHPK vs. AK dhe Classic SHPK versus AK	Shfuqizim i VKK Nr. 154 datë 01.10.2010.	Rrethi Gjyqësor Tirane	Bashkim çështjesh – Vazhdon gjykimi
4. Ultra Motors Shpk vs. AK	Shfuqizim i VKK Nr. 154 datë 01.10.2010.	Rrethi Gjyqësor Tirane	Pushuar / fituar
5. Hyundai Auto Albania Shpk vs. AK	Shfuqizim i VKK Nr. 154 datë 01.10.2010.	Rrethi Gjyqësor Tirane	Pushuar /Fituar
6. Romano Port SHA vs. Autoriteti i Konkurrencës	Shfuqizimi i VKK Nr. 197 datë 29.07.2011	Rrethi Gjyqësor Tirane	Vazhdon gjykimi
7. Atlas SHA vs. AK	Shfuqizim i VKK Nr. 125 datë 08.10.2009	Rrethi Gjyqësor Tirane	Pranuar Padia/Humbur
8. Vodafone Albania SHA Vs. AK	Shfuqizimi i VKK Nr. 59 datë 09.11.2007	Apeli Tirane	Lenje ne Fuqi te vendimit te Shkalles se Pare /Fituar
9. Ultra Motors Shpk vs. AK	Shfuqizim i VKK Nr. 154 datë 01.10.2010.	Apeli Tirane	Lenje ne fuqi te vendimit te Shkalles se Pare /Fituar
10. Hyundai Auto Albania SHPK vs. AK	Shfuqizim i VKK Nr. 154 datë 01.10.2010.	Apeli Tirane	Lenje ne fuqi te vendimit te Shkalles se Pare /Fituar
11. Çalik Seker Konsorsyum Yatirim AS vs. AK	Shfuqizimi i VKK Nr. 38 datë 16.05.2006	Gjykata e Larte	Mospranim rekursi /Fituar
12. Shoqerite e sigurimit versus AK	Anullimi tërësisht i VKK Nr. 54 datë 19.01.2007	Gjykata e Larte	Mospranim rekursi/Fituar

Shtojcë 7: Matrica e vlerësimeve të dhëna nga Autoriteti i Konkurrencës për vitin 2011

Nr.	Objekti:	Nisma:	Vlerësimi i Autoritetit të Konkurrencës	Sa është marrë në konsideratë
<u>1.</u>	Dhenie mendimi mbi Projekt-Kontraten “Për Shërbime në Ujësjellës-Kanalizime”.	Shkresa Nr. Ekstra Prot datë 14.01.2011 e Entit Rregullator të Ujrave per dhenie mendimi mbi Projekt-Kontraten “Për Shërbime në Ujësjellës-Kanalizime”.	Autoriteti i Konkurrencës ka shprehur mendimin e tij mbi kete P /Rregullore gjate pjesemarrjes se perfaqesuesve te tij ne Workshopin konsultues me teme “Drejt një kontrate Model për Shërbimin e Ujësjellës-Kanalizimeve” te zhvilluar nga ERRU me datës 21.01.2011 per diskutimin e kesaj P/Rregulloreje. Konkretisht perfaqesuesit e AK-se jane shprehur se: ne këndvështrimin e konkurrencës, pas analizes se bere aktit te sjellë për diskutim nga ana e ERRU, nuk ka pasur vërejtje apo ndonjë sugjerim ndaj tij, lidhur me fushën që mbulon AK, pasi p/kontrata nuk prekte, ose cenonte gjë me dispozitat e saj në këtë drejtim.	
<u>2.</u>	Vlerësim Ligjor i P/Rregullores “Për Cilësinë e Shërbimit të Shpërndarjes dhe Shitjes së Energjisë Elektrike” dhe P/Kontratës së “Furnizimit me Energji Elektrike për Konsumatorët Tariforë”.	Shkresa Nr. 53 Prot. datë 24.01.2011 per dhenie opinionin në lidhje me Projekt Rregulloren “Për Cilësinë e Shpërndarjes dhe Shitjes së energjisë Elektrike”, si dhe të Projekt – Kontratës së “Furnizimit me Energji Elektrike për Konsumatorët Tariforë” nga ERE.	Autoriteti i Konkurrencës, me anë të Shkresës nr. 53/1, dt. 9.2.2011 “Ne lidhje me projekt kontraten e energjise elektrike”, drejtuar ERRE, eshet shprehur si vijon: I. Komisioni i Konkurrences ka rekomanduar me vendimin nr. 159, dt. 19.11.2010 ‘Pershejtimin e procesit te rishikimit te Kontrates me Klientet tarifore duke percaktuar detyrimet e Furnizuasit Publik me Pakice per mbrojtjen e konsumatorit nepermjet respektimit te treguesve te cilesise se sherbimit” dhe vlereson nismen e ERRE per miratimin e kontrates tip te Cez Shperndarje sh.a me klientet tarifore. I. Aktet e paraqitura nuk bien ne kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, dhe per kete arsye shprehet dakord ne parim. I. Duke marre ne konsiderate interesin e pergjithshem publik dhe faktin qe operaori Cez Shperndarje sh.a eshte monopol ne tregun perkates te shperndarjes se energjise elektrike, Komisioni i Konkurrences shprehet per disa ndryshime ne draft-kontraten e paraqitur. Propozimet e KK jane si vijon: 1) Të parashikohet ne kontrate qe fatura e energjise elektrike per klientet	

			<p>tarifore te permbaje te detajuar cmimin dhe vleren e energjise se konsumuar sipas prodhimit, transmetimit dhe shperndarjes per te bere transparent per konsumatorët menyren e formimit te cmimit.</p> <p>2) Ne kontrate duhet te parashikohet procedura dhe mekanizmi i demshperblimit per klientet tarifor, pasi ne draft nuk eshte percaktuar qarte se si duhet te vepohet ne rastet e demshperblimeve qe pesojne klientet tarifore (elektroshtepiake, makineri etj.).</p> <p>3) Ne kontrate duhet te percaktohet qarte data dhe menyra se si klientet do te kene ne dispozicion te tyre faturen e furnizimit, madje te kete penalitete per furnizuesin nese nuk e paraqet faturen brenda kushteve te percaktuara ne kontrate. Keto penalitete mund te jene te njejta me ato qe paguan konsumatori per cdo dite vonese ne pagesen e energjise elektrike (0.1% e vleres se fatures).</p> <p>4) Te percaktohet ne draft-kontrate menyra e faturimit, vlere dhe cmimi qe paguajne klientet per ambjentet e perbashketa.</p> <p>5) Ne draft-kontrate duhet parashikuar struktura tarifore orare e ndryshme per klientet tarifore ne momentin e lidhjes se kontrates, pervec pasqyrimin ne menyre te vecante ne faturen perfundimtare te klientit (sic thuhet ne draft-kontrate).</p> <p>6) Matesat te jene te certifikuar edhe nga Drejtoria e Metrologjise dhe Enti Rregullator i Energjise Elektrike te parashikojë afatet se kur matesat do te vendosen ne bokse transparente te aksesueshme nga klienti per efekte te transparences se konsumit te energjise elektrike.</p> <p>7) Ne 8.2.1 te percaktohen saktësisht parametrat e cilesise se tensionit ne baze te se ciles lejohet devijimi (p.sh 220 V, nga i cili lejohet nje devijim sipas percaktimit te nenit 8.2.1).</p>	
3.	Vleresim mbi projekt kontratën “Për shërbimin e kontrollit fillestar dhe atij periodik të aparatit matës”.	Shkresa Nr. 175 Prot., datë 08.04.2011 per “Projekt-Kontratën “Për shërbimin e kontrollit fillestar dhe atij periodik të aparatit matës”,	<p>Autoriteti i Konkurrencës, me anë të Shkresës nr. 175/1/2 prot, dt. 28.04.2011 “Vleresim mbi projekt kontratën “Për shërbimin e kontrollit fillestar dhe atij periodik të aparatit matës”, drejtuar Entit Rregullator te Energjisë, eshte shprehur se: Projekt-Kontrata nuk bie në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.</p> <p>Gjithsesi për një qartësim dhe harmonizim më të mirë të dispozitave të jane dhene sugjerimet e meposhtme:</p>	

		nga Enti i Rregullator Energjisë.	<p>1. Në pjesën XII, neni 12.1.4 i Kontratës parashikon të drejtën e Kontraktorit të aplikojë ndryshime të njëanshme të tarifave të shërbimit të cilat janë të lidhura ne kostot e tij të realizimit të shërbimeve Sipas mendimit tonë, meqenëse tarifat janë të rregulluara atherë, në pikën 12.1.4 duhet të theksohet se ndryshimi i njëanshëm i tarifave në këto raste duhet të aplikohet sipas parashikimeve në Aneks 4 të kësaj Kontrate.</p> <p>2. Sugjerojmë që në pjesën Aneks 2 (Përkufizime), përsa i përket përkufizimeve të: 'Mosmarrëveshjeve' dhe 'Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST)' tu bëhet një riformulim (sipas legjislacionit ne fuqi), pasi rezultojnë të paqarta;</p> <p>3. Gjithashtu edhe përkufizimet që kanë të bëjnë me konceptet: 'Verifikim', 'Verifikim i rregullt i një instrumenti matës', 'Verifikim jashtë instrumentit matës', 'Autorizim', 'Certifikim', 'Matës kontrolli', të rishikohen pasi janë të përsëritura.</p>	
4.	Dhënie mendimi mbi projekt-vendimi i Komisionit të Ndihmës Shtetërore mbi planin e dhënies së ndihmës shtetërore "Për kryerjen nga "Posta Shqiptare" sh.a., të shërbimeve postare, financiare dhe shërbimeve të tjera, që janë në përputhje me aktivitetin e "Posta Shqiptare" sh.a.,	Shkresa nr. 77, dt. 8.2.2011 "Dërgohet për mendim projekt-vendimi i Komisionit të Ndihmës Shtetërore", nga METE.	<p>Autoriteti i Konkurrencës, me anë të Shkresës nr. 77/1 prot të datës 11.02.2011 "Kthim përgjigje", drejtuar METE, është shprehur se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në kushtet e mungesës së Planit të Postës Shqiptare dhe draft-kontratës që do të nënshkruante Ministri i Inovacionit me Postën Shqiptare, Komisioni shprehet pjesërisht lidhur me draft-vendimin duke qenë parimisht dakord, por në përputhje vetëm me referencën ligjore të përcaktuar në nenin 3, pika 14 dhe nenin 11 të ligjit "Për shërbimin postar" lidhur me "shërbimet e rezervuara"; - Të rishikohet afati 5 vjecar për dhënien e ndihmës shtetërore sipas pikës 5 të pjesës verejtëse të projekt-vendimit, me synimin mbajtjen parasysh të angazhimeve në favor të një procesi sa më të shpejtë të liberalizimit të shërbimit postar; - Komisioni rekomandon marrjen parasysh të mendimeve të palëve dhe grupeve të interes që mund të preken nga vendimi i Komisionit të Ndihmës Shtetërore. 	
5.	Vleresim mbi draftin mbi "Rregullat dhe procedurat standard për faturimin e demit ekonomik"	Shkresa nr. 98, dt. 16.02.2011 "Për dhenie mendimi" e ERE.	<p>Autoriteti i Konkurrencës, me anë të Shkresës nr. 98/1, dt. 9.3.2011 "Në lidhje me draftin mbi "Rregullat dhe procedurat standard për faturimin e demit ekonomik", drejtuar ERE, është shprehur se: draft-rregullorja nuk bie ne kundërshtim me ligjin 9121. Gjithashtu Komisioni dëshiron të sjellë në vëmendje faktin se kjo rregullore duhet të garantojë sa më mire ruajtjen e barazisë reale ndërmjet palëve duke pasur parasysh lehtësimin e pozitës</p>	

			së konsumatorit.	
6.	Për disa rekomandime në lidhje me draft rregulloren për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit.	Shkresa nr. 65 prot,dt.27.01.2011 “Për dhenie mendimi” si dhe shkresa nr. 78 prot, dt.8.2.2011 “Për dhenie mendimi” te ERE.	Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit nr. 177, dt. 25.02. 2011 “Për disa rekomandime në lidhje me draft rregulloren për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit”, vendosi: “1. Ti rekomandojë Entit Rregullator të Energjisë që në hartimin e rregullores për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit: a. Të saktësohet se sa do të jetë kohëzgjatja e “periudhës tranzitore”, apo kushti përkatës me plotësimin e të cilit do të përfundojë kjo periudhë tranzitore. b. Të saktësohet se çfarë do të ofrohet për tregun (operatorët e tregut) pas periudhës tranzitore, me qëllim që operatorët e licencuar apo që kanë investuar për të operuar në tregun e energjisë elektrike të konkurrojnë duke ofruar shërbime të cilat te ndikojnë drejtpërdrejtë në përfitime për klientin tarifor. c. Të mos ketë kufizime në lidhje me numrin e ofertave për zhvillimin e ankandeve. d. Në alokimin e kapaciteteve të rezervuara t’i jepet prioritet kërkesave për plotësimin e nevojave për transmetim e interkonjeksion për klientët tariforë. e. Në alokimin e kapaciteteve të rezervuara të parashikohet në mënyrë të veçantë mënyra e përballimit të situatave emergjente hidroenergjetike.”	
7.	Dhënie mendimi mbi draft - Metodologjinë Për Vendosjen e Tarifave, të ERRU-së.	Shkresa Nr. 209 Prot, datë 12.05.2011 per dhenie mendimi mbi draft – Metodologjinë për Vendosjen e Tarifave, nga ERRU	Autoriteti i Konkurrencës, me anë të Shkresës nr. 238 prot, dt. 7.6.2011 “Dhënie mendimi mbi draft - Metodologjinë Për Vendosjen e Tarifave, të ERRU-së”, drejtuar ERRU, është shprehur se: parë nën këndvështrimin e Ligjin nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, kjo Metodologji nuk bie në kundërshtim me këtë ligj, duke u shprehur pa verejtje per te.	
8.	Vlerësim në lidhje me P/Rregulloren “Për	Shkresa Nr. 322 Prot. datë	Autoriteti i Konkurrencës, me anë të Shkresës nr. 262 prot, dt. 30.06.2011 “Mbi draft-rregulloren për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit te klientit	

	Kriteret e Dhënies dhe Heqjes së Statusit 'Klient i Kualifikuar', dërguar nga ERE.	14.06.201, protokolluar pranë AK me Nr. 251 datë 15.06.2011 e ERE	te kualifikuar", drejtuar ERRE eshte shprehur se: Draft rregullorja e paraqitur per mendim eshte ne perputhje me ligjin nr. 9121 "Për mbrojtjen e konkurrencës". Me ane te ketij projekt-akti jane marre ne considerate rekomandimet e AK dhene me vendimin nr. 90, date 7.10.2008 "Per disa rekomandime per liberalizimin dhe rritjen e konkurrences ne sektorin e energjise elektrike". Që të garantohet me tej konkurrenca e lire dhe efektive ne kete sector, eshte e rendesishme qe te garantohet aksesimi mbi baza jo diskriminuese si dhe transparenca e ketij segmenti tregu duke u bazuar ne "Rregullat e tregut shqiptar te energjise elektrike", miratuar nga Bordi i Komisionereve te ERE-s me vendimin nr. 68, dt. 23.06.2008, pika XIV.7, ne te cilen percaktohen elementet teknike per ushtrimin e statutit te klientit te kualifikuar ne tregun e energjise elektrike. Per sa me siper eshte propozuar qe ne draft rregulloren e paraqitur te percaktohen <i>detyrimet, tarifat e ndertimit te statusit, termat, kushtet e sherbimeve dhe afatet kohore per pajisjen me matesa, apo elemnte te tjere teknike me qellim berjen efektive dhe funksionimin normal te Klientit te Kualifikuar.</i>	
9.	Mbi draftet e "Rregullores për miratimin e lidhjeve të reja në sistemin e shpërndarjes" dhe "Marrëveshjes për lidhjen e re"	Shkresa nr. 229 prot, dt. 2.6.2011 për dhënie mendimi, e ERE	Autoriteti i Konkurrencës, me anë të Shkresës nr. 252 prot, dt. 16.6.2011 "Mbi draftet e "Rregullores për miratimin e lidhjeve të reja në sistemin e shpërndarjes" dhe "Marrëveshjes për lidhjen e re", drejtuar ERE, eshte shprehur se: Bazuar në modelin aktual të tregut të energjisë elektrike, draft-rregullorja për lidhjet e reja, duhet të ndajë dh etë përcaktoje qart rolin dhe funksionin e OSSH dhe FPP, me qëllim që ta bëjë sa më funksional dhe konkurrues tregun e energjise elektrike. Në draft rregulloren e paraqitur për mendim vihet re që Cez shpërndarje konsiderohet si një operator I vetëm, pa marrë në konsiderat faktin se brenda tij veprojnë dy segmente të rëndësishme tregu (OSSH dhe FPP) për të cilët Komisioni është shprehur me rekomandimet përkatëse në vendimin nr. 159, dt. 19.11.2010.	
10	Dhënie mendimi mbi draft – Kodin e Qeverisjes së Korporatave.	Shkresa Nr. 348 Prot, datë 08.08.2011e METE për mendim mbi draft Kodin e	Autoriteti i Konkurrencës per "Dhënie mendimi mbi draft – Kodin e Qeverisjes së Korporatave", drejtuar Ministrit te Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes, eshte shprehur se: pas shqyrtimit të këtij draft-Kodi, duke vlerësuar parimet bazë të evidentuara mbi qeverisjen e Korporatave, parë nën këndvështrimin e Ligjin nr. 9121 "Për mbrojtjen e konkurrencës", ky draft – Kod nuk bie në kundërshtim me këtë ligj.	

		Qeverisjes së Korporatave.		
11	Mbi kërkesën “Për një ndryshim në Rregulloren e Alokimit të Kapacitetve të Interkoneksionit”	Shkresa nr. 423, dt. 23.09.2011 “Për një ndryshim në Rregulloren e Alokimit të Kapacitetve të Interkoneksionit”	Autoriteti i Konkurrencës, me anë të Shkresës nr. 448, dt. 5.10.2011 “Në lidhje me kërkesën “Për një ndryshim në Rregulloren e Alokimit të Kapacitetve të Interkoneksionit”, drejtuar ERE, është shprehur se: Përsa i përket pretendimeve në lidhje me arsyet teknike të paraqitura nga palët, është ERE organi Kompetent që do të bëjë vlerësimin e drejtë të situatës. AK kërkon që përmirësimi i Kapacitetve të Interkoneksionit dhe ndryshimet pozitive të ndodhura, të garantojnë aksesin mbi baza jo diskriminuese, transparente dhe konkurruese të të gjithë operatorëve të licensuar në tregun e energjisë elektrike.	
12.	Dhënie mendimi mbi aplikimin e paraqitur për përjashtimin nga palët e treta të subjektit Trans-Adriatic Pipeline (TAP).	Shkresa nr. 457 prot, datë 12. 10. 2011 e ERE per dhënie mendimi në lidhje me aplikimin e paraqitur për përjashtimin nga palët e treta të subjektit Trans-Adriatic Pipeline (TAP).	Autoriteti i Konkurrencës, me anë të Shkresës nr. 496 prot, dt. 9.11.2011 “Dhënie mendimi mbi aplikimin e paraqitur për përjashtimin nga palët e treta të subjektit Trans-Adriatic Pipeline (TAP)”, drejtuar ERE, është shprehur se: <i>“Në parim përjashtimet e kërkuara në aplikimin në fjalë mund të përbëjnë kufizim të konkurrencës. Informacioni i depozituar nuk mundëson realizimin e analizës së plotë mbi shkallën e kufizimit të konkurrencës. Nga diskutimi dhe konsultimi me ekspertët e projektit IPA 2008 sugjerojmë:</i> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Mundësinë e reduktimit të afatit të përjashtimit nga aksesit i palëve të treta;</i> - <i>Dhënia e përjashtimit për 80% të kapacitetit të shfrytëzimit duke lënë një kapacitet 20% të lirë për aksesit i palëve të treta të tregut vendas;</i> - <i>Parashikimi në projekt i pikave dalëse (exit point), me qëllim bërjen të mundur nga ana teknike në cdo kohë të përfitimit nga tregu vendas.”</i> Gjithashtu AK, duke vlerësuar bashkpunimin midis ekspertëve të institucioneve përkatëse, shprehet për vazhdimin e këtij bashkpunimi për gjatë gjithë procesit.	

13.	Vlerësimi i ankesës së Shoqatës Shqiptare të Bankave lidhur me ndryshimet ne udhezimin e Ministrit te Arsimit per procedurat e pageses per pranimin dhe regjistrimin ne ciklin e pare te studimeve me kohe te plote ne institucionet publike te arsimit te larte.	Shkresa Nr. 452 Prot, datë 06.10.2011e Shoqates Shqiptare te Bankave lidhur me përjashtimin e bankave nga tregu i shërbimit të pagesës për regjistrimin në institucionet publike të arsimit të lartë.	Autoriteti i Konkurrencës, me anë të Vendimit Nr. 205, datë 14/11/2011 “Për një rekomandim për Ministrin e Arsimit dhe Shkencës për ndryshimin e udhëzimit nr. 36, dt. 9.9.2011 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 25, dt. 20.07.2011 ”Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë”. Vendosi: “T’i rekomandojë Ministrit të Arsimit dhe Shkencave që të ndryshojë Udhëzimit nr. 36, dt. 9.9.2011 në mënyrë që të shmangë kufizimet për konkurrencën në tregun e shërbimeve financiare dhe të mundësojë që pagesat e regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë të kryhen si nëpërmjet filialeve të Postës Shqiptare ashtu edhe në filialet e bankave të nivelit të dytë.”	
14.	Dhenie mendimi mbi projekt-VKM “Për propozimin e projekt-ligjit për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”	Shkresa e MITIK nr. 166 Prot, datë 01.04.2011 për kërkim mendimi mbi projekt-VKM .	Autoriteti i Konkurrencës, me anë të Shkresës nr. 166/1 prot, dt. 28.04.2011 “Dhenie mendimi mbi projekt-VKM “Për propozimin e projekt-ligjit për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë””, drejtuar MITIK, pas shqyrtimit të projekt-VKM-se është shprehur se kjo e fundit nuk ka dispozita që bien në ndesh me ligjin 9121.	
15.	Vlerësim mbi projekt-Ligjin “Për Burimet e Energjisë së Rinovueshme”	Shkresa Nr.514, dt. 23.11.2011, për kërkim mendimi mbi projekt-ligjin “Për Burimet e Energjisë së Rinovueshme”.	Autoriteti i Konkurrencës, me anë të Shkresës Nr. 514/1, dt. 19.12.2011 “Dhënie mendimi mbi projekt-ligjin “Për Burimet e Energjisë së Rinovueshme”, drejtuar METE, është shprehur se: Ky ligj synon të promovojë dhe nxitë prodhimin e energjive të rinovueshme, dhe do të ndikojë në nxitjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në tregun e prodhimit të enegjisë. Mëgjithatë Komisioni shpreh rezervat e tij në lidhje me nenin 17 të Projektligjit, i cili mund të sjellë kufizime të konkurrencës efektive në këtë segment tregu. Gjithashtu Komisioni ka sugjeruar që në projektligj të përcaktohen më qartë detyrimi që tarifat e transmetimit dhe shpërndarjes të jenë jo-diskriminuese për prodhuesit dhe përfituesit e energjisë së	

			rinovueshme si dhe mos-diskriminim për shkak të vend-ndoshjes apo sasisë së ulët të energjisë. Projekt ligji duhet të përcaktoje se shteti do të hartojë politika nxitëse si dhe krijimin e kapacitetve të mjaftueshme transmetuese.	
--	--	--	--	--

Shtojcë 8. Buxheti faktik i Autoritetit të Konkurrencës

	Plani	Fakti	Mbetje	Në %
Shpenzime personeli	41.620.000	36.911.576	4.708.424	88.7%
Kontribute sigurime shoqerore	5.200.000	5.054.843	145.157	97.2%
Materiale dhe sherbime	8.109.000	8.043.101	65.899	99.2%
Investime	4.000.000	2.735.060	1.264.940	68.4%
Totali:	59.379.000	53.194.580	6.184.420	90%

